



Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 2.2, 3.4, 15.1 (a), (c), (d), (e), (j), 21.2, 57 dhe 59 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta zyrtare" e Republikës së Kosovës, Viti III, Nr. 28, 4 qershor 2008),

Me qëllim të përshkrimit të autoritetit kompetent kombëtar, programit për transportin e mallrave të rrezikshme përmes ajrit, përjashtimet, aprovimet, lirimet, klasifikimet, kufizimet mbi transportin e mallrave të rrezikshme, paketimin, etiketimin dhe shënjimin, përgjegjësinë e dërguesve të mallrave, përgjegjësinë e operatorëve, përgjegjësinë e shpeditërëve, përgjegjësinë e ofruesve të shërbimeve të trajtimit në tokë dhe agjentëve të trajtimit të mallrave, deponimin, ofrimin e informacioneve, trajnimin, ruajtjen e dokumenteve dhe të dhënave, mekanizmat e përputhshmërisë dhe zbatimit, raportimin e ndodhive të mallrave të rrezikshme dhe dispozitave që kanë të bëjnë me sigurimin e mallrave të rrezikshme,

Pas përfundimit të procesit të konsultimit publik me të gjitha palët e interesuara në pajtim me Udhëzimin Administrativ nr. 01/2012 për konsultimin publik të palëve të interesuara,

Nxjerr këtë:

**RREGULLORE Nr. 8/2014 PËR  
KUSHTET DHE MËNYRËN E TRANSPORTIMIT TË MALLRAVE TË RREZIKSHME  
PËRMES AJRIT**

**Neni 1  
Fushëveprimi**

1.1 Kjo Rregullore përshkruan autoritetin kompetent kombëtar, programin për transportin e mallrave të rrezikshme përmes ajrit, përjashtimet, aprovimet, lirimet, klasifikimet, kufizimet mbi transportin e mallrave të rrezikshme, paketimin, etiketimin dhe shënjimin, përgjegjësinë e dërguesve të mallrave, përgjegjësinë e operatorëve, përgjegjësinë e shpeditërëve, përgjegjësinë e ofruesve të shërbimeve të trajtimit në tokë dhe agjentëve të trajtimit të mallrave, deponimin, ofrimin e informacioneve, trajnimin, ruajtjen e dokumenteve dhe të dhënave, mekanizmat e përputhshmërisë dhe zbatimit,

raportimin e ndodhive të mallrave të rrezikshme dhe dispozitave që kanë të bëjnë me sigurimin (mbrojtjen nga ndërhyrjet e paligjshme) e mallrave të rrezikshme.

1.2 Kjo Rregullore është e zbatueshme ndaj autoritetit kompetent kombëtar dhe palëve vijuese të aprovuara:

- a) dërguesve të mallrave;
- b) shpediterëve;
- c) ofruesve të shërbimeve të trajtimit në tokë dhe agjentëve të trajtimit të mallrave;
- d) operatorëve, dhe
- e) ofruesve të trajnimit.

1.3 Kjo Rregullore është e zbatueshme ndaj çdo organizate, kompanie apo individi që ofron shërbime të lidhura me:

- a) dërgesat e mallrave të rrezikshme të ofruara për transport ajror; dhe
- b) trajtimin e udhëtarëve dhe bagazhit.

1.4 Kjo Rregullore është e zbatueshme ndaj operatorit postar të emëruar.

1.5 Dispozitat e kësaj rregulloreje si dhe dispozitat e Instruksioneve Teknike për Transportin e Sigurt të Mallrave të Rrezikshme Përmes Ajrit (ICAO Doc 9284-AN/905) do të zbatohen për të gjitha operimet e mjeteve ajrore civile të angazhuara në transportin ajror ndërkombëtar dhe vendor.

1.6 Mallrat e rrezikshme të destinuara për transport përmes ajrit dhe të përgatitura në përputhje me Instruksionet Teknike do të pranohen për transport rrugor drejt ose nga aeroportet në pajtim me Ligjin për transportin tokësor të mallrave të rrezikshme.

## **Neni 2 Përkufizimet**

Termet e përdorur në këtë Rregullore kanë kuptimet e mëposhtme:

**Agjent i trajtimit** (*Handling agent*) - nënkupton kompaninë/organizatën e caktuar nga një kompani ajrore për të kryer funksione të ofruesit të shërbimit të trajtimit në tokë;

**Aksident i mallrave të rrezikshme** (*Dangerous goods accident*) - nënkupton ndodhinë e lidhur me transportin e mallrave të rrezikshme përmes ajrit që rezulton me vdekje ose lëndim serioz të ndonjë personi ose dëmtim madhor të pronës apo mjedisit;

**Ambalazh (Packaging)** - nënkupton një ose më shumë enë (mbështjellëse) dhe çdo komponent ose material tjetër të nevojshëm që ena ta kryejë funksionin e saj të mbajtjes dhe funksionet tjera të sigurisë;

**Ambalazh i brendshëm (Inner packagings)** - nënkupton ambalazhet për të cilat është i nevojshëm një ambalazh i jashtëm për transport;

**Ambalazh i jashtëm (Outer packaging)** - nënkupton mbrojtjen e jashtme të ambalazhit kompozitë ose të kombinuar së bashku me çdo material absorbues, zbutësit dhe çdo komponent tjerë të nevojshme për të mbajtur dhe mbrojtur enët e brendshme apo ambalazhin e brendshëm;

**Ambalazh i kombinuar (Combination packagings)** - nënkupton kombinimin e ambalazheve për qëllime transporti, të përbëra nga një ose më shumë ambalazhe të brendshme të futura në një ambalazh të jashtëm në përputhje me dispozitat përkatëse të Pjesës 4 të Instruksioneve Teknike.

**Anëtar i ekuipazhit (Crew member)** - nënkupton personin e caktuar në detyrë nga operatori në mjet ajror gjatë një periudhe të detyrës së fluturimit;

**Aprovim (Approval)** - nënkupton autorizimin e lëshuar nga autoriteti kompetent kombëtar për:

- a) transportin e mallrave të rrezikshme që janë të ndaluara në mjetet ajrore të udhëtarëve dhe/ose mjetet ajrore të mallrave, për të cilat në Instruksionet Teknike thuhet se mund të barten me aprovim; ose
- b) qëllime të tjera të parapara në Instruksionet Teknike;

**Aprovim (Approval) për transportin e materialit të Klasës 7** - nënkupton aprovimin e lëshuar nga Agjencia e Kosovës për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore (AKMRrSB) në koordinim me Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës (AACK).

- a) **Aprovim i shumanshëm** - nënkupton aprovimin nga autoriteti përkatës kompetent i Shtetit të origjinës së dizajnit apo i dërgesës, siç është e aplikueshme, si dhe, kur dërgesa duhet të transportohet përmes ose në ndonjë Shtet tjetër, aprovimin nga autoriteti kompetent i atij Shteti.
- b) **Aprovim i njëanshëm** - nënkupton aprovimin e një dizajni i cili kërkohet të jepet vetëm nga autoriteti kompetent i Shtetit të origjinës së dizajnit;

**Certifikatë për mallrat e rrezikshme (Dangerous goods Certificate)** - nënkupton certifikatën e lëshuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil i Republikës së Kosovës që konfirmon se organizata, ndërmarrja ose personi i cili ofron shërbime në lidhje me transportin e mallrave të rrezikshme përmes ajrit përmbush kushtet e përcaktuara;

**Anëtar i ekuipazhit të fluturimit** (*Flight crew member*) - nënkupton anëtarin e ekuipazhit të fluturimit. Një anëtar i licencuar i ekuipazhit i ngarkuar me detyra që janë esenciale për operimin e mjetit ajror gjatë një periudhe të detyrës së fluturimit;

**Organi kompetent** (*Competent Authority*) - nënkupton organin apo autoritetin e caktuar apo të pranuar ndryshe si të tillë për çdo qëllim të lidhur me Instruksionet Teknike;

**Bagazh** (*Baggage*) - nënkupton pronën personale të udhëtarëve ose ekuipazhit të bartur në mjet ajror me marrëveshje me operatorin;

**Bateri litiumi** (*Lithium battery*) – “Bateri” nënkupton dy ose më shumë qelia të cilat janë të lidhura së bashku në mënyrë elektrike dhe të pajisura me pajisje të nevojshme për përdorim, për shembull, shtëpiza, polet, shënjimete dhe pajisjet mbrojtëse. Bateria e litiumit me një qeli të vetme konsiderohet si një “qeli”. Termi “bateri litiumi” i referohet një familjeje të substancave kimike të ndryshme, që përfshijnë shumë lloje të katodave dhe elektroliteve. Për qëllime të legjislacionit ato janë të ndara në:

- Bateri litiumi metalike; dhe
- Bateri litium-joni (ndonjëherë të emëruara me shkurtesën bateri Li-ion);

**Dërgesë** (*Consignment*) - nënkupton një ose më shumë pako të mallrave të rrezikshme të pranuar nga ana e operatorit nga një dërgues në një kohë dhe një adresë të caktuar, të pranuar në një pjesë dhe që barten tek një pranues në një adresë të destinacionit;

**Dërgues** (*Shipper*) - nënkupton çdo person, organizatë apo organ i cili ka të drejtë për të përgatitur dërgesën për transport;

**EU-OPS** - nënkupton Rregulloren e Këshillit (EEC) Nr. 3922/91 të datës 16 dhjetor 1991 mbi harmonizimin e kërkesave teknike dhe procedurave administrative në fushën e aviacionit civil, siç është ndryshuar;

**Grup paketimi** (*Packing group*) - nënkupton treguesin e shkallës relative të rrezikut të paraqitur nga artikujt dhe substancat e ndryshme brenda një klase apo divizioni. Numrat romak I, II dhe III përdoren për të paraqitur “rrezik të lartë”, “rrezik të mesëm” dhe “rrezik të ulët” respektivisht;

**IATA** - nënkupton Asociacionin Ndërkombëtar të Transportuesve Ajror;

**ICAO** - nënkupton Organizatën Ndërkombëtare të Aviacionit Civil;

**Incident me mallra të rrezikshme** (*Dangerous goods incident*) - nënkupton një ndodhi, përveç aksidentit të mallrave të rrezikshme, të lidhur me transportin e mallrave të rrezikshme përmes ajrit, që jo domosdoshmërisht ndodhë në bordin e mjetit ajror, e cila rezulton me lëndim të ndonjë personi, dëmtim të pasurisë apo mjedisit, zjarr, thyerje,

derdhje, rrjedhje të lëngut apo rrezatim apo me dëshmi tjera që integriteti i ambalazhit nuk është ruajtur. Çdo ndodhi në lidhje me transportin e mallrave të rrezikshme, që rrezikon seriozisht mjetin ajror apo personat që gjenden në të, gjithashtu konsiderohet si incident i mallrave të rrezikshme;

**Inspektor (Inspector)** - nënkupton punonjës in e Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës, të cilit i është dhënë ky titull pas përmbushjes së kushteve të nevojshme të përcaktuara në Manualin përkatës dhe në përputhje me procedurat e përcaktuara në Manualin e Cilësisë, që ka të drejtë të kryejë detyra specifike mbikëqyrëse të përcaktuara në këtë Rregullore dhe në Ligjin Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil;

**Instruksiione Teknike (Technical Instructions)** - nënkupton botimin e fundit të Instruksiioneve Teknike të ICAO-së për Transportin e sigurt të mallrave të rrezikshme përmes ajrit (Doc 9284), të aprovuara dhe publikuara me vendim të Këshillit të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil;

**Jokompatibil (Incompatible)** - përshkruan mallra të rrezikshme të cilat, nëse përzihen, mund të shkaktojnë ngritjen e rrezikshme të nxehtësisë ose lirim in e gazit ose të prodhojnë substanca korrozive;

**Kodet IMP të Mallrave (Cargo IMP Codes)** - nënkupton sistemin standard të kodimit për elementet e mesazhit të ngarkesave. Kodet IMP përdoren nga operatorët gjatë shkëmbimit të të dhënave në mënyrë që të minimizojnë kohën e transmetimit të të dhënave;

**Konventa e Bazelit (Basel Convention)** - nënkupton Konventën mbi Kontrollimin e qarkullimit ndërkufitar të mbetjeve të rrezikshme dhe depozitimit të tyre, e miratuar më 22 mars 1989 në Bazel.

**Kufizimet (Limitations)** - nënkupton kufizimet që janë vendosur për mallrat e rrezikshme të cilat janë të lejuara për t'u transportuar përmes ajrit;

**Leje (Permission)** - nënkupton autorizimin e lëshuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës (AACK) në koordinim me Agjencinë e Kosovës për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore (AKMRrSB) respektivisht Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB) për transportin e armëve dhe municionit, duke përfshirë eksplozivët, si dhe të mallrave tjera të rrezikshme, si gazrat e dëmshme ose toksike, karburantet nukleare dhe materialet radioaktive.

**Lëndim serioz (Serious injury)** - nënkupton lëndimin e pësuar nga një person në aksident dhe i cili:

- a) kërkon hospitalizim për më shumë se 48 orë, duke filluar brenda shtatë ditëve nga data në të cilën është pësuar lëndimi; ose
- b) rezulton në thyerje të çdo kocke (përveç thyerjeve të thjeshta të gishtave të duarve, këmbëve ose të hundës); ose

- c) përfshin gërvishtje që shkaktojnë gjakderdhje të mëdha, lëndime të nervave, të muskujve ose të pjezës; ose
- d) përfshin lëndim të cilitdo organ të brendshëm; ose
- e) përfshin djegie të shkallës së dytë apo të tretë, ose çfarëdo djegie që afekton më shumë se 5 për qind të sipërfaqes së trupit; ose
- f) përfshin ekspozimin e verifikuar ndaj substancave infektuese apo rrezatimit të dëmshëm;

**Lirim (Exemption)** - nënkupton autorizimin, përveç aprovimit, të lëshuar nga autoriteti kompetent kombëtar që mundëson shmangie nga dispozitat e Instruksioneve Teknike.

**Mall i rrezikshëm i padeklaruar (Undeclared dangerous goods)** - nënkupton mallin e rrezikshëm të ofruar për transport përmes ajrit që nuk është i shoqëruar me Deklaratën e dërguesit për mallrat e rrezikshme, me informatën në formë elektronike në lidhje me dërgesën ose, nëse është e lejuar, me ndonjë dokument tjetër;

**Mallra (furnizime) (Stores (supplies))** - a) Mallra (furnizime) për konsum; dhe b) Mallra (furnizime) që merren me vete.

*Mallra (furnizime) për konsum.* Mallrat, që shiten apo nuk shiten, të destinuara për konsum nga ana e udhëtarëve dhe e ekuipazhit në bord të mjetit ajror, dhe mallrat e nevojshme për operimin dhe mirëmbajtjen e mjetit ajror, duke përfshirë karburantin dhe lubrifikantët.

*Mallra (furnizime) që merren me vete.* Mallrat të cilat u shiten udhëtarëve dhe ekuipazhit të mjetit ajror me qëllim të përdorimit pas aterritimit.

Artikujt të cilët plotësojnë klasifikimin si mallra të rrezikshme dhe të cilat transportohen në përputhje me Pjesën 1, 2.2.2 ose Pjesën 1; 2.2.3 konsiderohen si "ngarkesë";

**Mallra të rrezikshme (Dangerous goods)** - nënkupton artikujt ose substancat që janë në gjendje të paraqesin rrezik për shëndetin, sigurinë, pronën apo mjedisin dhe që janë të paraqitura në listën e mallrave të rrezikshme në Instruksionet Teknike, apo të cilat janë të klasifikuara sipas Instruksioneve Teknike;

**Mallra të rrezikshme të deklaruar gabimisht (Misdeclared dangerous goods)** - nënkupton mallra të rrezikshme të ofruara për transport përmes ajrit, të cilat:

- a) janë shënuar gabimisht në Deklaratën e dërguesit për mallrat e rrezikshme në mënyrë që kur ato do të shënoheshin si duhet, nuk do të pranoheshin për transport, ose

- b) janë gjetur, gjatë procedurës normale të pranimit, që nuk i plotësojnë dispozitat e Instruksioneve Teknike;

**Mbikëqyrës i ngarkesës (Loadmaster)** - nënkupton anëtarin e ekuipazhit në mjet ajror mallrash përgjegjës për ngarkimin e mallrave dhe personelit si dhe për peshën dhe balancimin e mjetit ajror;

**Mbi-paketim (Overpack)** - nënkupton mbështjelljen e përdorur nga një dërgues i vetëm që përmban një ose më shumë pako dhe që formon një njësi trajtimi për lehtësimin e trajtimit dhe deponimit. Pajisja për ngarkesë të njësisë nuk është e përfshirë në këtë përkufizim;

**Mjet ajror i mallrave (Cargo aircraft)** - nënkupton çdo mjet ajror, përveç mjetit ajror të udhëtarëve, i cili bart mallra ose pasuri;

**Mjet ajror i udhëtarëve (Passenger aircraft)** - nënkupton mjetin ajror që bart çdo person tjetër përveç anëtarëve të ekuipazhit, punonjësve të operatorit në cilësi zyrtare, përfaqësuesve të autorizuar të ndonjë autoriteti kompetent kombëtar ose personave që shoqërojnë ndonjë dërgesë apo ngarkesë tjetër;

**Mostra të pacientëve (Patient specimens)** - nënkupton mostrat e mbledhura drejtpërdrejt nga njerëzit apo kafshët, duke përfshirë, por pa u kufizuar në jashtëqitje, sekrete, gjak dhe komponente të tij, inde dhe mostra të fluideve të indeve, si dhe në pjesë të trupit që transportohen për qëllime të tilla si kërkimi, diagnostikimi, aktivitete të hetimit, trajtimi dhe parandalimi i sëmundjeve;

**Ngarkesë (Cargo)** - për qëllime të kësaj Rregulloreje, nënkupton çdo pasuri të bartur në mjet ajror përveç postës dhe bagazhit të shoqëruar ose të pashoqëruar;

**Numër ID (ID number)** - nënkupton numrin e përkohshëm të identifikimit të specifikuar në Instruksionet Teknike për një artikull të mallrave të rrezikshme të cilit nuk i është caktuar një numër UN;

**Numër UN (UN number)** - nënkupton numrin katër-shifror të caktuar nga Komiteti i Ekspertëve për Transportin e Mallrave të Rrezikshme i Kombeve të Bashkuara për të identifikuar një substancë ose një grup të veçantë të substancave;

**Ofrues i trajnimeve (Training provider)** - nënkupton personin, organizatën apo ndërmarrjen që ofron trajnime;

**Operator (Operator)** - nënkupton personin, organizatën apo ndërmarrjen e angazhuar ose që ofron për t'u angazhuar në operimet me mjete ajrore;

**Operator i emëruar postar (Designated postal operator)** - nënkupton çdo entitet qeveritar apo joqeveritar të emëruar zyrtarisht nga Republika e Kosovës për të ofruar shërbime postare dhe për të përmbushur, në territorin e vet, detyrimet që dalin nga Konventa e Unionit Postar Universal (UPU);

***Pajisje për ngarkesë të njësisë (Unit load device)*** - nënkupton çdo lloj të kontejnerit të ngarkesave, kontejnerit të mjetit ajror, paletës së mjetit ajror me rrjetë ose paletës së mjetit ajror me rrjetë mbi mbështjellëse (igloo). Mbi-paketimi ose kontejneri i ngarkesave për materiale radioaktive nuk përfshihet në këtë përkufizim;

***Pako (Package)*** - nënkupton produktin e plotë të operacionit të paketimit, të përbërë nga ambalazhi dhe përmbajtja e tij të përgatitur për transport;

***Përjashtim (Exception)*** - nënkupton dispozitën e kësaj Rregulloreje dhe Instruksioneve Teknike e cila përjashton ndonjë artikull të caktuar të mallrave të rrezikshme nga kërkesat që normalisht janë të zbatueshme për atë artikull;

***Pilot komandues (Pilot-in-command)*** - nënkupton pilotin e caktuar nga operatori, ose në rastin e aviacionit të përgjithshëm, nga pronari, për të komanduar dhe të ngarkuar për kryerjen e sigurt të fluturimeve;

***Postë (Mail)*** - nënkupton dërgesat e korrespondencës dhe gjërave tjera të ofruara nga shërbimet postare dhe të destinuara për liferim nga shërbimet postare në përputhje me rregullat e Unionit Postar Universal (UPU).

***Pranues i dërgesës (Consignee)*** - nënkupton çdo person, organizatë apo organ i cila ka të drejtë që ta pranojë dërgesën;

***Program i mallrave të rrezikshme (Dangerous goods program)*** - nënkupton aktivitetet e kryera nga autoriteti kompetent kombëtar për të përmbushur kërkesat e Aneksit 18 - Transporti i sigurt i mallrave të rrezikshëm përmes ajrit të ICAO-së;

***Program i trajnimit (Training program)*** - nënkupton metodën e zhvilluar për kryerjen e trajnimeve, të përbërë nga ligjëratat, materialet e lidhura me kursin (të tilla si broshurat, projeksionet, video materialet, ushtrimet, etj.), shembujt e pyetjeve të testit dhe shënime të mësimdhënies;

***Qeli e litiumit (Lithium cells)*** - nënkupton njësinë e vetme të mbështjellë elektro-kimike (një elektrodë pozitive dhe një negative) e cila krijon tension të ndryshëm ndërmjet dy terminaleve të saj;

***Sigurim i mallrave të rrezikshme (Dangerous goods security)*** - nënkupton masat ose masat paraprake që duhet të ndërmerren nga operatorët, dërguesit dhe të tjerët që janë të përfshirë në transportin e mallrave të rrezikshme me mjet ajror për të minimizuar vjedhjen apo keqpërdorimin e mallrave të rrezikshme që mund të rrezikojnë personat apo pasurinë;

***Shpeditër (Freight forwarder)*** - nënkupton personin ose organizatën që ofron shërbimin e aranzhimit të transportit të mallrave përmes ajrit;



*Shtet i destinacionit (State of Destination)* - nënkupton shtetin në territorin e të cilit dërgesa përfundimisht shkarkohet nga mjeti ajror;

*Shtet i operatorit (State of the Operator)* - nënkupton shtetin në të cilin gjendet vendi kryesor i veprimtarisë së operatorit ose, nëse nuk ka vend të tillë të veprimtarisë, vendqëndrimi i përhershëm i operatorit;

*Shtet i origjinës (State of Origin)* - nënkupton shtetin në territorin e të cilit për herë të parë ngarkohet dërgesa në mjet ajror;

*Trajnim dhe vlerësim i bazuar në kompetencë (Competency-based training and assessment)* - nënkupton trajnimin dhe vlerësimin që karakterizohen me orientim në performancë, me theks në standardet e performancës dhe matjen e tyre, si dhe zhvillimin e trajnimeve sipas standardeve të specifikuara të performancës;

*Trajnim i familjarizimit të përgjithshëm (General familiarisation training)* - nënkupton trajnimin që synon familjarizimin me kërkesat e përgjithshme të Instruksioneve Teknike;

*Trajnim periodik (Recurrent training)* - nënkupton trajnimin që ofrohet brenda 24 muajve pas trajnimit paraprak për t'u siguruar që njohuritë mbesin aktuale. Megjithatë, nëse trajnimi periodik kryhet brenda tre muajve të fundit të vlefshmërisë së trajnimit paraprak, periudha e vlefshmërisë shtrihet nga muaji në të cilin kryhet trajnimi periodik deri në 24 muaj nga muaji i skadimit të trajnimit paraprak;

*Trajnim i sigurisë (Safety training)* - nënkupton trajnimin që tregon rreziqet që paraqesin mallrat e rrezikshme, trajtimin e sigurt dhe reagimin në situata emergjente;

*Trajnim specifik për funksionin (Function specific training)* - nënkupton trajnimin i cili ka për qëllim ofrimin e njohurive të detajuara për kërkesat e Instruksioneve Teknike proporcionalisht me përgjegjësitë e atij personeli.

### **Neni 3**

#### **Autoriteti Kompetent Kombëtar**

3.1 Autoriteti i Aviacionit Civil i Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtuqjeshëm AACK) është autoriteti kompetent kombëtar në Republikën e Kosovës përgjegjës për transportin e mallrave të rrezikshme përmes ajrit, në pajtim me kriteret e ICAO-së.

3.2 AACK harton legjislacionin sekondar dhe propozon ndryshime të legjislacionit për transportin e sigurt të mallrave të rrezikshme përmes ajrit. AACK merr masat e nevojshme për të arritur harmonizimin e rregullave kombëtare me dispozitat e përcaktuara në Instruksionet Teknike dhe ndryshimet e tyre që mund të publikohen gjatë periudhës së caktuar të zbatimit të botimit të fundit të Instruksioneve Teknike në fuqi.

3.3 Në mënyrë që të lehtësohet transporti i patrazuar i mallrave të rrezikshme nga një shtet tjetër në territorin e Republikës së Kosovës, në përputhje me ndryshimet e Instruksioneve Teknike, të cilat për arsye sigurie fillojnë të aplikohen menjëherë , por që akoma nuk kanë hyrë në fuqi në Republikën e Kosovës, AACK do të sigurojë transportin e mallrave të tilla të rrezikshme, në përputhje me këto ndryshime të Instruksioneve Teknike, me kusht që mallrat të jenë në përputhje të plotë me kërkesat e ndryshuara.

3.4 AACK informon ICAO-në për legjislacionin e aprovuar në Republikën e Kosovës dhe mbi vështirësitë e hasura në zbatimin e Instruksioneve Teknike dhe, nëse është e nevojshme, propozon ndryshimin apo plotësimin e Instruksioneve Teknike.

3.5 AACK do të bashkëpunojë me autoritetet kompetente të shteteve të tjera në lidhje me shkeljen e legjislacionit që rregullon transportin e mallrave të rrezikshme, me qëllim për t'i dhënë fund shkeljeve të tilla. Bashkëpunimi mund të përfshijë koordinimin e hetimeve dhe masave që detyrojnë përputhshmërinë, shkëmbimin e informacioneve për statusin rregullator në periudhën e mëparshme, inspektimet e përbashkëta dhe aktivitetet tjera, shkëmbimin e stafit profesional dhe pjesëmarrjen në takime dhe konferenca të përbashkëta. Informacionet e përshtatshme që autoritetet mund të shkëmbejnë janë njoftimet e sigurisë, buletinët apo njoftimet për mallrat e rrezikshme, masat ligjore të propozuara dhe të ndërmarra, raportet e ndodhive, dokumentet dhe provat tjera të mbledhura gjatë hetimit të ndodhive, masat e propozuara dhe përfundimtare korrigjuese të ndërmarra për të siguruar përputhshmërinë dhe materialet e përdorura në trajnime/kërkime, të përshtatshme për publikun e gjerë.

3.6 AACK rishikon dhe aprovon procedura për ta kontrolluar shërbimin postar në lidhje me pranimin e mallrave të rrezikshme që ndodhen në pakot postare ose në postë që transportohen përmes ajrit, në përputhje me procedurat ndërkombëtare për kontrollin e futjes së mallrave të rrezikshme përmes ajrit të vendosura nga Unioni Postar Universal.

#### **Neni 4**

#### **Programi për transportin e mallrave të rrezikshme përmes ajrit**

4.1 AACK e nxjerr dhe, kur është e nevojshme, e ndryshon programin për transportin e mallrave të rrezikshme përmes ajrit.

4.2 Prioritetet e programit për transportin e mallrave të rrezikshme bazohen në:

- a) dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil dhe të akteve nenligjore për zbatimin e tij ;
- b) prioritetet e përcaktuara nga Drejtori i Përgjithshëm i AACK-së, në përputhje me prioritetet e programeve ndërkombëtare dhe kombëtare;

c) trajnimin e punonjësve profesional dhe kompetent, të cilëve u janë deleguar përgjegjësitë në lidhje me mallrat e rrezikshme, dhe të cilët ndjekin trajnime të përkatëse për të qenë në gjendje që të kryejnë detyrat e tyre të deleguara;

d) përgatitja e planeve për:

i) aktivitetet e mbikëqyrjes (inspektimet dhe auditimet);

ii) trajnimet, dhe

iii) sigurimin e fondeve të nevojshme.

4.3 AACK lëshon dhe, kur është e nevojshme, ndryshon programin e informimit të publikut të aviacionit në lidhje me mallrat e rrezikshme.

4.4 AACK sigurohet që informacionet të publikohen në mënyrë të tillë që të paralajmërohen udhëtarët për ato lloje të mallrave të rrezikshme të cilat janë të ndaluara për transport ajror siç është e përcaktuar në Instruksionet Teknike.

4.5 AACK emëron personin(at) kontaktues për zbatimin e programit për transportin e mallrave të rrezikshme dhe për këtë e informon ICAO-në.

4.6 Aktivitetet kryesore të personit(ave) të emëruar për zbatimin e programit për transportin e mallrave të rrezikshme janë:

a) pjesëmarrja në punën e Komisionit Kombëtar Ndërministror për Transport të Mallrave të Rrezikshme, i cili vepron si organ këshillues i Ministrisë së Infrastrukturës, për koordinimin e transportit të mallrave të rrezikshme në mes të ministrive dhe agjencive përkatëse;

b) përgjigjja në pyetjet e industrisë së aviacionit në lidhje me kushtet dhe mënyrën e transportit të mallrave të rrezikshme përmes ajrit;

c) pjesëmarrja në përgatitjen e legjislacionit dhe kërkesave kombëtare për transportin e mallrave të rrezikshme;

d) kryerja e certifikimit dhe mbikëqyrjes së subjekteve të përfshira në transportin e mallrave të rrezikshme përmes ajrit;

e) rishikimi i manualeve dhe programeve të trajnimit;

f) kryerja e hetimeve të ndodhive që janë rezultat i shkeljes së legjislacionit mbi mallrat e rrezikshme;

- g) përfaqësimi i AACK-së në takime dhe punëtori, në lidhje me mallrat e rrezikshme, të organizuara nga organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe shoqatat profesionale, dhe
- h) planifikimi, përgatitja dhe zbatimi i programit të informimit të publikut të aviacionit që udhëton për mallrat e rrezikshme.

## **Neni 5 Përfundimet**

5.1 Artikujt dhe substancat që klasifikohen si mallra të rrezikshme, të cilat është e nevojshme të jenë në bordin e mjetit ajror në përputhje me kërkesat përkatëse të vlefshmërisë ajrore dhe ato operative, ose ata artikuj dhe substanca që kanë qëllim të veçantë të përcaktuar në Instruksionet Teknike, përjashtohen nga dispozitat e kësaj Rregulloreje.

5.2 Artikujt dhe substancat e destinuara për zëvendësimin e atyre të përshkruara në paragrafin 1 të këtij neni, ose artikujt dhe substancat të cilat janë zëvendësuar, duhet të transportohen në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulloreje, përveç nëse parashikohet ndryshe në Instruksionet Teknike.

5.3 Artikujt dhe substanca të caktuara të bartura nga udhëtarët ose anëtarët e ekuipazhit përjashtohen nga dispozitat e kësaj Rregulloreje, në përputhje me Instruksionet Teknike.

## **Neni 6 Aprovimi**

6.1 Kur shprehimisht përcaktohet në Instruksionet Teknike, AACK mund të lëshojë aprovim për të lejuar transportin e mallrave të rrezikshme të ndaluara në mjetet ajrore të udhëtarëve dhe/ose mallrave, me kusht që në rastet e tilla arrihet një nivel i përgjithshëm i sigurisë në transport i cili është i barabartë me nivelin e sigurisë të përcaktuar në Instruksionet Teknike.

6.2 Në mungesë të një reference të veçantë në Instruksionet Teknike që lejon lëshimin e aprovimin, mund të kërkohet lëshimi i një lirimi.

6.3 Formulari i kërkesës për lëshimin e aprovimin ose lirimit për bartjen e mallrave të rrezikshme të referuara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni është në dispozicion në faqen e internetit të AACK-së)

## **Neni 7**

### **Lirimi**

7.1 Me përjashtim të artikujve dhe substancave që janë të ndaluara për transport përmes ajrit në të gjitha rrethanat, AACK mund të lëshojë lirim nga dispozitat e Instruksioneve Teknike me kusht që operatori të demonstrojë që niveli i përgjithshëm i sigurisë në transport të jetë i barabartë me nivelin e sigurisë të përcaktuar në Instruksionet Teknike në rastet e:

- a) urgjencës ekstreme, ose
- b) kur format tjera të transportit janë të papërshtatshme, ose
- c) kur përmbushja e plotë e kërkesave të përcaktuara është në kundërshtim me interesin e përgjithshëm.

7.2 Në rastin e mbi-fluturimeve, kur nuk është i aplikueshëm asnjëri nga kriteret për lëshimin e lirit, lirimi mund të jepet vetëm në bazë të besimit që është arritur një nivel ekuivalent i sigurisë në transportin ajror.

7.3 Udhëzimet për trajtimin e aplikacioneve për lirime, duke përfshirë edhe shembuj të emergjencave ekstreme, mund të gjenden në Shtojcën e Instruksioneve Teknike (Pjesa S-1, 1.2 dhe 1.3).

## **Neni 8**

### **Leja**

8.1 Sipas nenit 57 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, armët dhe municioni, duke përfshirë eksplozivët, mund të barten në bord të mjetit ajror vetëm:

- i)* me leje të veçantë me shkrim të AACK-së,
- ii)* nën mbikëqyrjen e pilotit komandues, dhe
- iii)* në përputhje të plotë me legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar.

8.2 Sipas nenit 59 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, mallrat tjera të rrezikshme, si gazrat e dëmshme ose helmuese, karburantet nukleare dhe materialet radioaktive mund të barten vetëm:

- i)* me leje të veçantë me shkrim të AACK-së, dhe
- ii)* vetëm sipas kushteve të përcaktuara nga AACK në rregulloret e tij zbatuese të LAC-it, të cilat marrin parasysh rregullat dhe rregulloret ekzistuese vendore dhe ndërkombëtare.

8.3 Formulari i kërkesës për lëshimin e lejes për bartjen e mallrave të rrezikshme të referuara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij është në dispozicion në faqen e internetit të AACK-së.

## **Neni 9**

### **Klasifikimi i mallrave të rrezikshme**

9.1 Substancat (duke përfshirë përzierjet dhe tretësirat) dhe artikujt e referuar në këtë Rregullore dhe Instruksionet Teknike janë të caktuara në njëërën nga nëntë klasat varësisht nga rreziku apo rreziku dominues që mund të paraqesin. Disa nga këto klasa janë ndarë në divizione.

9.2 Këto klasa dhe divizione janë siç është paraqitur më poshtë:

#### **Klasa 1: Eksplozivët**

- Divizioni 1.1: Substancat dhe artikujt të cilët paraqesin rrezik të shpërthimit masiv
- Divizioni 1.2: Substancat dhe artikujt të cilët paraqesin rrezik të shpërthimit, por jo rrezik për shpërthimit masiv
- Divizioni 1.3: Substancat dhe artikujt të cilët paraqesin rrezik të zjarrit dhe rrezik të plasjes së vogël ose rrezik të shpërthimit të vogël apo të të dyjave, por jo rrezik për shpërthimit masiv
- Divizioni 1.4: Substancat dhe artikujt të cilët nuk paraqesin ndonjë rrezik të konsiderueshëm
- Divizioni 1.5: Substancat shumë të pandjeshme të cilat paraqesin rrezik të shpërthimit masiv
- Divizioni 1.6: Artikujt shumë të pandjeshëm të cilët nuk paraqesin rrezik të shpërthimit masiv

#### **Klasa 2: Gazrat**

- Divizioni 2.1: Gazrat e ndezshme
- Divizioni 2.2: Gazrat jo-të ndezshme, jo-toksike
- Divizioni 2.3: Gazrat toksike

#### **Klasa 3: Lëngjet e ndezshme**

#### **Klasa 4: Ngurtësirat e ndezshme; substancat që mund të digjen spontanisht; substancat të cilat në kontakt me ujin emetojnë gazra të ndezshme**

- Divizioni 4.1: Ngurtësirat e ndezshme, substancat vetë-reaktive dhe të lidhura dhe eksplozivët e pandjeshëm
- Divizioni 4.2: Substancat që mund të digjen spontanisht

Divizioni 4.3: Substancat të cilat në kontakt me ujin emetojnë gazra të ndezshme

**Klasa 5: Substancat oksiduese dhe peroksidet organike**

Divizioni 5.1: Substancat oksiduese

Divizioni 5.2: Peroksidet organike

**Klasa 6: Substancat toksike dhe infektuese**

Divizioni 6.1: Substancat toksike

Divizioni 6.2: Substancat infektuese

**Klasa 7: Materiali radioaktiv**

**Klasa 8: Substancat korrozive**

**Klasa 9: Substancat dhe artikujt e ndryshëm të rrezikshëm, duke përfshirë substancat e rrezikshme për mjedisin**

9.3 Renditja numerike e klasave dhe divizioneve nuk përcakton shkallën e rrezikut.

9.4 Shumë nga substancat e përfshira në klasat 1 deri në 9, edhe pa etiketim shtesë, konsiderohen si të rrezikshme për mjedisin.

9.5 Mbetjet duhet të transportohen sipas kërkesave të klasës përkatëse, duke marrë parasysh rreziqet që ato mund të paraqesin dhe kriteret e përcaktuara në Instruksionet Teknike. Mbetjet të cilat nuk përfshihen në Instruksionet Teknike, por që mbulohen nga Konventa e Bazelit, mund të transportohen sipas klasës 9.

9.6 Për qëllime të paketimit, substancat tjera përveç atyre të klasave 1, 2 dhe 7, divizioneve 5.2 dhe 6.2 dhe substancat vetë-reaktive të divizionit 4.1 janë të ndara në tri grupe të paketimit në përputhje me shkallën e rrezikut që paraqesin:

Grupi i paketimit I: Substancat që paraqesin rrezik të lartë

Grupi i paketimit II: Substancat që paraqesin rrezik të mesëm

Grupi i paketimit III: Substancat që paraqesin rrezik të ulët

9.7 Mallrat e rrezikshme që paraqesin rrezik të vetëm një klase dhe divizioni janë të caktuara në atë klasë dhe divizion dhe, nëse është e aplikueshme, i është përcaktuar shkalla e rrezikut (grupi i paketimit). Kur një artikull apo substancë është listuar në mënyrë specifike me emër në listën e Instruksioneve Teknike, klasa apo divizioni i saj, rreziku (rreziqet) i saj suplementar dhe, kur është e aplikueshme, grupi i saj i paketimit merren nga ajo listë.

9.8 Kur një substancë ose artikull nuk është listuar në mënyrë specifike me emër në listën e mallrave të rrezikshme të Instruksioneve Teknike dhe ekzistojnë dy ose më shumë rreziqe të klasës 3, 4 ose 8 apo të divizionit 5.1 ose 6.1 të lidhura me transportin ajror të tyre dhe sipas përkufizimit i përket të dyja prej këtyre klasave apo divizioneve në Instruksionet Teknike, ai klasifikohet në përputhje me prioritetin sipas tabelës së rreziqeve në Instruksionet Teknike.

## **Neni 10**

### **Kufizimet në transportin e mallrave të rrezikshme përmes ajrit**

10.1 Mallrat e rrezikshme të përshkruara më poshtë janë të ndaluara në mjetet ajrore përveç nëse AACK lëshon ndonjë lirim në përputhje me nenin 7 të kësaj Rregulloreje ose përveç nëse dispozitat e Instruksioneve Teknike tregojnë se ato mund të transportohen sipas aprovimit të lëshuar nga shteti i origjinës:

- a) mallrat e rrezikshme që janë të identifikuar në Instruksionet Teknike si të ndaluara për transport në rrethanat normale; dhe
- b) kafshët e gjalla të infektuara.

10.2 Artikujt dhe substancat që janë të identifikuar në mënyrë specifike me emër ose me përshkrim gjenerik në Instruksionet Teknike si të ndaluara për transport përmes ajrit në të gjitha rrethanat nuk duhet të barten në asnjë mjet ajror.

## **Neni 11**

### **Paketimi**

11.1 Mallrat e rrezikshme duhet të paktohen në përputhje me dispozitat e këtij neni dhe siç parashikohet në Instruksionet Teknike.

11.2 Ambalazhi që përdoret për transportin e mallrave të rrezikshme përmes ajrit duhet të jetë i kualitetit të mirë dhe duhet të konstruktohet dhe mbyllet në mënyrë të sigurt për të parandaluar rrjedhjet që mund të shkaktohen në kushtet normale të transportit, nga ndryshimet e temperaturës, lagështisë apo shtypjes, apo nga vibrimet.

11.3 Ambalazhi duhet të jetë i përshtatshëm për përmbajtjen. Ambalazhi në kontakt të drejtpërdrejtë me mallrat e rrezikshme duhet të jetë rezistent ndaj çdo veprimi kimik apo tjetër të këtyre mallrave.

11.4 Ambalazhi duhet të jetë në përputhje me specifikimet e përcaktuara në Instruksionet Teknike në lidhje me materialet dhe konstruktimin.

11.5 Ambalazhi duhet të testohet në pajtim me dispozitat e Instruksioneve Teknike.



11.6 Ambalazhi për të cilin mbajtja e ndonjë lëngu është funksion themelor, duhet të jetë në gjendje të përballojë, pa rrjedhur, shtypjen e deklaruar në Instruksionet Teknike.

11.7 Ambalazhi i brendshëm duhet të jetë i paketuar në mënyrë të tillë, i fiksuar apo i mbështjellë me zbutës të goditjeve për të parandaluar thyerjen apo rrjedhjen e tij dhe për të kontrolluar lëvizjen e tij brenda ambalazhit të jashtëm gjatë kushteve normale të transportit ajror. Materialet zbutëse dhe absorbuese nuk duhet të reagojnë në mënyrë të rrezikshme me përmbajtjen e ambalazhit.

11.8 Asnjë ambalazh nuk duhet të ripërdoret deri sa të mos inspektohet dhe të zbulohet që nuk ka korrozion ose dëmtime të tjera. Kur një ambalazh ripërdoret, duhet të merren të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar ndotjen e përmbajtjes së re.

11.9 Nëse, për shkak të natyrës së përmbajtjes së tyre të mëparshme, ambalazhet e zbrazëta të papastra mund të paraqesin rrezik, ato duhet të mbyllen fort dhe të trajtohen në bazë të rrezikut që paraqesin.

11.10 Asnjë sasi e dëmshme e ndonjë substance të rrezikshme nuk guxon të gjendet në pjesën e jashtme të pakove.

## **Neni 12** **Etiketimi dhe shënjimi**

12.1 Secila pako e mallrave të rrezikshme duhet të etiketohet me etiketë përkatëse dhe në përputhje me dispozitat e përcaktuara nga Instruksionet Teknike.

12.2 Secila pako e mallrave të rrezikshme duhet të shënjohet me emrin e saktë të dërgimit së përmbajtjes së vet dhe, nëse ekziston, me numrin UN dhe shenjat tjera të tilla siç mund të jenë të specifikuar në Instruksionet Teknike.

12.3 Etiketimi dhe shënjimi duhet të jenë të përhershme dhe të dukshme, gjatë procesit të pranimit, dërgimit, transportit dhe deponimit. Etiketat dhe shenjat e kërkuara nga Instruksionet Teknike nuk duhet të mbulohen apo pengohen nga ndonjë pjesë apo shtojcë e ambalazhit ose ndonjë etiketë apo shenjë tjetër.

12.4 Ambalazhi i prodhuar sipas specifikimeve të përmbajtura në Instruksionet Teknike duhet të shënohet në përputhje me dispozitat përkatëse të Instruksioneve Teknike dhe asnjë ambalazh nuk guxon të shënjohet me shenjë për specifikim të ambalazhit nëse nuk i plotëson specifikimet përkatëse të ambalazhit të përmbajtura në Instruksionet Teknike.

12.5 Për të gjitha fluturimet ndërkombëtare të cilat nisen nga Republika e Kosovës, gjuhët zyrtare duhet të përdoren për shënjimin e mallrave të rrezikshme, përveç gjuhës angleze e cila mund të kërkohet nga shteti i tranzitit apo destinacionit.

## Neni 13 Certifikata për mallrat e rrezikshme

13.1 Mallrat e rrezikshme duhet të pranohen dhe përcillen vetëm nga ato subjekte (dërguesit, shpeditërit, ofruesit e shërbimit të trajtimit në tokë, agjentët e trajtimit të mallrave dhe operatorët) të cilave AACK u ka lëshuar certifikatë si kompetente për të kryer këto operime, dhe të cilat janë në posedim të një certifikate të vlefshme për mallrat e rrezikshme.

13.2 Për të marrë certifikatën për mallrat e rrezikshme, subjekti duhet:

- a) të dorëzojë formularin e plotësuar të aplikimit për lëshimin/ripërtëritjen e Certifikatës për mallrat e rrezikshme, me dokumentet e nevojshme mbështetëse (formulari i aplikimit është në dispozicion në faqen e internetit të AACK-së);
- b) të krijojë procedura të brendshme (Procedura Standarde Operative - SOP), që përshkruajnë në detaje procesin e pranimit, deponimit dhe përcjelljes së një dërgese të mallrave të rrezikshme, raportimin e ndodhive që përfshijnë mallrat e rrezikshme dhe një pasqyrë të detajuar të procedurave operative. Procedurat standarde operative mund të gjenden në dokumente tjera (p.sh. manuali i Operimeve, manuali i Aerodromeve, etj.);
- c) të ketë qasje në legjislacionin e vlefshëm të mallrave të rrezikshme; dhe
- d) të emërojë një koordinator për mallrat e rrezikshme, i cili duhet të pranohet nga AACK.

13.3 Certifikata për mallrat e rrezikshme lëshohet për një periudhë që nuk është më e gjatë se dy vite nga data e lëshimit, me përjashtim të artikujve të listuar në nenin 8 të kesaj Rregulloreje.

13.4 Poseduesi i certifikatës për mallrat e rrezikshme është përgjegjës për dorëzimin me kohë të aplikacionit për ripërtëritjen e certifikatës, para skadimit të afatit.

13.5 Operatorët ajror, vendi kryesor i biznesit i të cilëve është në Bashkimin Evropian, të cilëve Certifikata e Operatorit Ajror (AOC) i është lëshuar dhe që operojnë në përputhje me kërkesat e Aneksit III të Rregullores së Këshillit (EEC) 3922/91 (EU-OPS) të ndryshuar, nuk janë të detyruar që të marrin certifikatë për mallrat e rrezikshme të lëshuar nga AACK, me kusht që të kenë autorizim/aprovim të veçantë për transportin e mallrave të rrezikshme përmes ajrit, të lëshuar nga autoriteti kompetent i cili e ka lëshuar AOC-në.

13.6 Në qoftë se dërguesi nuk ka personel të trajnuar në përputhje me Instruksionet Teknike, ai mund të bëjë marrëveshje me shkrim me një shpeditë të certifikuar sipas rregullave, i cili në emër të dërguesit kryen detyrat e lidhura me dërgimin e mallrave të rrezikshme për transport përmes ajrit.

## **Neni 14**

### **Koordinatori për mallrat e rrezikshme**

14.1 Çdo dërgues, shpediter, ofruer i shërbimit të trajtimit në tokë dhe agent i trajtimit të mallrave i aprovuar dhe operatorët, që kryejnë aktivitete në lidhje me transportin e mallrave të rrezikshme përmes ajrit, duhet të caktojnë nga një ose më shumë koordinatorë për mallrat e rrezikshme.

14.2 Koordinatori për mallrat e rrezikshme mund të jetë menaxheri i ndërmarrjes, ose ndonjë person tjetër që kryen detyra të tjera në atë ndërmarrje, ose ndonjë person që nuk është i punësuar drejtpërdrejtë nga kjo ndërmarrje, me kusht që ky person të jetë i aftë të kryejë detyrat e koordinatorit për mallrat e rrezikshme.

14.3 Në lidhje me aktivitetet e ndërmarrësve, koordinatori për mallrat e rrezikshme i kryen detyrat e mëposhtme:

- a) monitoron përputhshmërinë me kërkesat për trajtimin dhe transportin e mallrave të rrezikshme;
- b) këshillon menaxhmentin dhe zyrtarët përgjegjës për transportin e mallrave të rrezikshme;
- c) përgatit raporte vjetore për menaxhmentin (raportet vjetore ruhen për një periudhë pesëvjeçare dhe duhet të jenë në dispozicion të AACK-së sipas kërkesës);
- d) siguron që të gjithë personat të jenë të trajnuar në mënyrë adekuate në pajtim me fushëveprimin e detyrave të tyre dhe të jenë në posedim të certifikatave për kalimin e provimit të lidhur me mallrat e rrezikshme;
- e) siguron mirëmbajtjen e shënimeve për mallrat e rrezikshme;
- f) mbikëqyr zbatimin e procedurave emergjente;
- g) përgatit dhe mbikëqyr mirëmbajtjen dhe përditësimin e procedurave të brendshme dhe dokumenteve përkatëse; dhe
- h) heton ndodhitë që përfshijnë mallrat e rrezikshme në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulloreje dhe i dorëzon raportet në AACK-ë.

14.4 Koordinatori për mallrat e rrezikshme duhet t'ia dorëzojë AACK-së formularin e aplikimit për pranimin e koordinatorit për mallrat e rrezikshme (në dispozicion në faqen e internetit të AACK-së), të shoqëruar me:

- a) kopjen e Certifikatës së vlefshme që ai/ajo ka përfunduar me sukses programin e trajnimit për mallrat e rrezikshme për kategorinë 6;
- b) dëshmi për të paktën dy vjet përvojë pune me mallrat e rrezikshme ose në operimet me ngarkesat, duke përfshirë pranimin dhe dërgimin, dhe
- c) biografinë (CV-në).

14.5 Me rastin e aplikimit për pranim, Certifikata e trajnimit, siç kërkohet në paragrafin 4 a) të këtij Neni, duhet të jetë e vlefshme për së paku tre muaj nga data e aplikimit dhe duhet të ofrohen informata për aranzhimin e trajnimit periodik.

14.6 Pas përfundimit të trajnimit periodik për mallrat e rrezikshme, koordinatori duhet t'ia dorëzojë AACK-së kopjen e certifikatës së vlefshme të trajnimit.

### **Neni 15** **Revokimi i Certifikatës për mallrat e rrezikshme**

15.1 AACK revokon përkohësisht Certifikatën për mallrat e rrezikshme të lëshuar poseduesit, në rastet kur:

- a) poseduesi i certifikatës nuk i plotëson më kushtet e përcaktuara nga kjo Rregullore, ose
- b) zbulohet që poseduesi i certifikatës ka qenë i përfshirë dhe/ose ka kontribuar në një aksident apo incident që përfshinë mallrat e rrezikshme ose në një ndodhi tjetër që ka mundur të rrezikojë ose vë në pikëpyetje sigurinë e transportit ajror, ose
- c) poseduesi i certifikatës nuk bashkëpunon sa duhet në lidhje me gjetjet e AACK-së dhe afatet e dhëna për mënjanimin e mos-përputhshmërive.

15.2 AACK revokon certifikatën për mallrat e rrezikshme në mënyrë të përhershme në rastet kur:

- a) kjo kërkohet nga poseduesi i certifikatës, ose
- b) poseduesi i certifikatës kryen veprimtari të cilat kërkojnë një aprovim tjetër, i cili nuk është marrë, ose
- c) poseduesi i certifikatës nuk arrin të ofrojë dëshmi për mënjanimin e gjetjeve që kanë çuar në revokimin e përkohshëm të aprovimit, ose
- d) poseduesi i certifikatës me qëllim ose nga pakujdesia i ka dorëzuar AACK-së informacione të pasakta për çështje të rëndësishme.

## **Neni 16**

### **Përgjegjësia e dërguesit**

16.1 Para se dërguesi të ofrojë ndonjë pako ose mbi-paketim të mallrave të rrezikshme për transport përmes ajrit, dërguesi duhet të sigurojë:

- a) që mallrat nuk janë të ndaluara për transport përmes ajrit;
- b) nëse mallrat janë të ndaluara për transport përmes ajrit pa aprovim paraprak, dërguesi është i obliguar që të marrë aprovimin, përveç atyre të specifikuar në Instruksionet Teknike;
- c) që mallrat të jenë të klasifikuara, paketuara, shënjuara dhe etiketuara në mënyrë të duhur dhe të shoqëruara nga një dokument i transportit të mallrave të rrezikshme i ekzekutuar në mënyrë të duhur, siç është specifikuar në këtë Rregullore dhe në Instruksionet Teknike.

16.2 Dërguesi duhet të sigurohet që dokumenti i transportit të mallrave të rrezikshme:

- a) përveç nëse është paraparë ndryshe në Instruksionet Teknike, dërguesi i mallrave të rrezikshme duhet ta plotësojë, nënshkruajë dhe ofrojë operatorit një dokument të transportit të mallrave të rrezikshme, i cili duhet të përmbajë informacionet e kërkuara nga Instruksionet Teknike;
- b) dokumenti i transportit duhet të ketë një deklaratë të nënshkruar nga dërguesi i mallrave të rrezikshme që tregon:
  - i) se mallrat e rrezikshme janë përshkruar plotësisht dhe me saktësi me emrat e tyre të saktë të dërgimit, dhe
  - ii) se ato janë klasifikuar, paketuara, shënjuar, etiketuar dhe janë në gjendje të rregullt për transport përmes ajrit në përputhje me legjislacionin përkatës;
- c) për të gjitha fluturimet ndërkombëtare të cilat nisen nga Republika e Kosovës, gjuhët zyrtare duhet të përdoren në dokumentin e transportit të mallrave të rrezikshme, përveç gjuhës angleze e cila mund të kërkohej nga shteti i tranzitit apo destinacionit.

## **Neni 17**

### **Përgjegjësia e operatorit**

17.1 Poseduesi i Certifikatës së Operatorit Ajror (AOC) të lëshuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës duhet të përfshijë në Manualin e Operimeve dhe

dokumentet tjera perkatëse, nëse është e aplikueshme, një pjesë në lidhje me procedurat perkatëse për ekuipazhin e fluturimit dhe atë tokësor në lidhje me deponimin dhe transportin e mallrave të rrezikshme përmes ajrit dhe një pjesë që ka të bëjë me procedurat për të siguruar që dërgesat e pranuar nga dërguesit dhe agjentët e ofruesve të shërbimeve të trajtimit në tokë janë në përputhje me kërkesat e Instruksioneve Teknike dhe duhet të përmbajnë procedurat emergjente në përputhje me Udhëzimin e ICAO-së për Reagim në Rastet Emergjente për Incidentet e Mjeteve Ajrore që Përfshijnë Mallrat e Rrezikshme (Doc. 9481 - AN/928).

17.2 Operatori i mjetit ajror nuk guxon të pranojë mallra të rrezikshme për transport përmes ajrit:

- a) përveç nëse mallrat e rrezikshme janë të shoqëruara me një dokument të kompletuar të transportit të mallrave të rrezikshme, përveç kur Instruksionet Teknike thonë që një dokument i tillë nuk është i nevojshëm; dhe
- b) deri kur pakoja, mbi-paketimi ose kontejneri i mallrave që përmban mallra të rrezikshme të jetë inspektuar në përputhje me procedurat e pranimit të përfshira në Instruksionet Teknike. (Vërejtje: Dispozitat e veçanta që kanë të bëjnë me pranimin e mbi-paketimeve janë të përfshira në Instruksionet Teknike).

17.3 Operatori duhet të zhvillojë dhe përdorë një listë kontrolli për pranim në pajtim me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni.

17.4 Pakot dhe mbi-paketimet që përmbajnë mallra të rrezikshme si dhe kontejnerët e mallrave që përmbajnë materiale radioaktive duhet të ngarkohen dhe deponohen në mjetin ajror në përputhje me dispozitat e Instruksioneve Teknike.

17.5 Pakot dhe mbi-paketimet që përmbajnë mallra të rrezikshme si dhe kontejnerët e mallrave që përmbajnë materiale radioaktive duhet të inspektohen për të vërtetuar që nuk ka rrjedhje ose dëmtim para ngarkimit në mjetin ajror ose në pajisje njësuere të ngarkimit. Pakot, mbi-paketimet apo kontejnerët e mallrave që rrjedhin apo janë të dëmtuar nuk guxojnë të ngarkohen në mjetin ajror.

17.6 Pajisja njësuere e ngarkimit nuk guxon të ngarkohet në bord të mjetit ajror nëse pajisja nuk është inspektuar dhe është vërtetuar që nuk ka rrjedhje nga, ose dëmtimit të, çfarëdo malli të rrezikshëm të vendosur në të.

17.7 Në rastet kur duket që ndonjë pako e mallrave të rrezikshme e ngarkuar në mjetin ajror është e dëmtuar ose rrjedhë, operatori duhet ta largojë pakon e tillë nga mjeti ajror, ose të aranzhojë largimin e saj nga një organ kompetent apo organizatë tjetër, dhe pas kësaj duhet të sigurojë që pjesa e mbetur e dërgesës është në gjendje të rregullt për transport përmes ajrit dhe që asnjë pako tjetër nuk është kontaminuar.

17.8 Pakot dhe mbi-paketimet që përmbajnë mallra të rrezikshme dhe kontejnerët e mallrave që përmbajnë materiale radioaktive duhet të inspektohen për shenja të dëmtimit

apo rrjedhjes pas shkarkimit nga mjete ajror apo pajisja njësuese e ngarkimit. Nëse vërtetohet se ka dëmtim apo rrjedhje, zona në mjet ajror në të cilën kanë qenë të vendosura mallrat e rrezikshme ose pajisja njësuese e ngarkimit duhet të inspektohet për shenja të dëmtimit apo ndotjes.

17.9 Mallrat e rrezikshme nuk guxojnë të barten në kabinën e mjetit ajror në të cilën ndodhen udhëtarët ose në kabinën e ekuipazhit të mjetit ajror, përveç në rrethanat e lejuara nga dispozitat e Instruksioneve Teknike.

17.10 Çdo ndotje e rrezikshme e cila gjendet në mjet ajror si rezultat i rrjedhjes apo dëmtimit të mallrave të rrezikshme duhet të mënjanohet pa vonesë.

17.11 Çdo kontaminim i rrezikshëm që gjendet në mjetin ajror si rezultat i rrjedhjes apo dëmtimit të mallrave të rrezikshme duhet të mënjanohet pa vonesë. Mjeti ajror, i cili është kontaminuar nga materialet radioaktive, duhet të raportohet tek AKMRrSB dhe largohet menjëherë nga operimi dhe nuk guxon të kthehet në operim derisa niveli i rrezatimit në cilëndo sipërfaqe të arritshme dhe kontaminimi jo-i-fiksuar të jenë mbi vlerat e përcaktuara në Instruksionet Teknike dhe rekomandimeve të AKMRrSB.

17.12 Pakot që përmbajnë mallra të rrezikshme të cilat mund të reagojnë në mënyrë të rrezikshme me njëra-tjetrën nuk guxojnë të vendosen në mjet ajror pranë njëra-tjetrës ose në një pozicion i cili do të lejonte ndërveprimin ndërmjet tyre në rast të rrjedhjes. Si minimum, skema e ndarjes e paraqitur në Instruksionet Teknike duhet të ndiqet për të ruajtur një ndarje të pranueshme ndërmjet pakove që përmbajnë mallra të rrezikshme që kanë rreziqe të ndryshme. Skema aplikohet pavarësisht nëse rreziku është rrezik primar apo suplementar.

17.13 Pakot e substancave toksike dhe infektuese duhet të vendosen në mjetin ajror në përputhje me dispozitat e Instruksioneve Teknike.

17.14 Pakot e materialeve radioaktive duhet të vendosen në mjetin ajror në atë mënyrë që të jenë të ndara nga njerëzit, kafshët e gjalla dhe filmat e pazhvilluar fotografik, në përputhje me dispozitat e Instruksioneve Teknike.

17.15 Materiali i magnetizuar duhet të ngarkohet ashtu që polet e busullave të mjeteve ajrore të jenë brenda tolerancave të përshkruara në kërkesat në fuqi të vlefshmërisë ajrore të mjeteve ajrore dhe, kur është praktike, në vendet ku minimizohen ndikimet e mundshme në busulla. Për materialin e magnetizuar që transportohet sipas kushteve të një aprovimi të përshkruar në Instruksionin e paketimit 953, ngarkimi duhet të bëhet në përputhje me kushtet e përcaktuara në aprovimin autorizues.

17.16 Akulli i thatë (dioksidi i karbonit, i ngurtë), kur dërgohet si i vetëm ose kur përdoret si lëndë ftohëse për artikujt tjerë, mund të bartet me kusht që operatori të ketë kryer aranzhimet e përshtatshme varësisht nga lloji i mjetit ajror, shkalla e ventilimit të mjetit ajror, mënyra e paketimit dhe deponimit, nëse kafshët barten në të njëjtin fluturim

dhe nga faktorët tjerë. Operatori duhet të sigurojë që personeli tokësor të jetë i informuar që akulli i thatë është duke u ngarkuar ose është në bordin e mjetit ajror.

17.17 Kur akulli i thatë ndodhet në një pajisje njësuere të ngarkimit ose në ndonjë paletë tjetër të përgatitur nga një dërgues i vetëm në përputhje me Instruksionin e paketimit 954 dhe operatori, pas pranimit, shton akull të thatë shtesë, atëherë operatori duhet të sigurojë që informacionet e dhëna pilotit komandues pasqyrojnë sasinë e korrigjuar të akullit të thatë.

17.18 Operatori duhet t'i mbrojë mallrat e rrezikshme të ngarkuara në mjetin ajror nga dëmtimi dhe duhet t'i fiksojë këto mallra të rrezikshme në mjet ajror në atë mënyrë që do të parandalonte çfarëdo lëvizje gjatë fluturimit, e cila do të ndryshonte orientimin e pakos.

17.19 Përveç siç është thënë në Instruksionet Teknike, pakot e mallrave të rrezikshme që mbajnë etiketën "Cargo Aircraft Only" (Vetëm në Mjet Ajror të Mallrave), duhet të ngarkohen në atë mënyrë që anëtari i ekuipazhit ose ndonjë person tjetër i autorizuar të mund të shohë, trajtojë dhe, kur madhësia dhe pesha lejojnë, të ndajë pakot e tilla nga mallrat e tjera gjatë fluturimit.

17.20 Operatori ose agjenti i tij i përgjithshëm i shitjes (General Sales Agent - GSA) duhet të mbajë shënime për dërguesit dhe shpediterët e aprovuar, me të cilët lidhë kontratë për transport të mallrave të rrezikshme përmes ajrit.

17.21 Operatori ose agjenti i tij i përgjithshëm i shitjes duhet t'i ofrojë ofruesit të shërbimeve të trajtimit në tokë dhe agjentit të trajtimit të mallrave shënimet e referuara në paragrafin paraprak. Këto shënime, sipas kërkesës, gjithashtu duhet t'i ofrohen edhe AACK-së.

## **Neni 18**

### **Përgjegjësia e shpediterit**

18.1 Shpediteri i cili në emër të dërguesit kryen klasifikimin, paketimin dhe shënjimin e dërgesës duhet të sigurojë që dispozitat për klasifikimin, paketimin dhe shënjimin të dhëna në këtë Rregullore dhe në Instruksionet Teknike do të përmbushen edhe atëherë kur dërguesi nënshkruan dokumentin e transportit të referuar në nenin 16.2 b) të kësaj Rregulloreje.

18.2 Përveç dispozitave të kësaj Rregulloreje që aplikohen për transportin e mallrave të rrezikshme përmes ajrit, shpediterët e angazhuar në aktivitete të shpedicionit duhet të aplikojnë edhe Kushtet e Përgjithshme të Asociacionit Ndërkombëtar të Federatës së Shpediterëve (FIATA).



## **Neni 19**

### **Përgjegjësia e Ofruesit të shërbimeve të trajtimit në tokë dhe e Agjentit të trajtimit të mallrave**

19.1 Ofruesi i shërbimeve të trajtimit në tokë dhe agjenti i trajtimit të mallrave në pajtim me dispozitat e marrëveshjes për shërbimet e trajtimit në tokë, merr përsipër përgjegjësinë e operatorit të mjetit ajror për përmbushjen e kërkesave të neneve 17.2, 17.3, 17.4, 17.5, 17.6, 17.8, 17.9, 17.10, 17.12, 17.13, 17.14, 17.15, 17.16, 17.17, 17.18 dhe 17.19 të kësaj Rregulloreje, kur kjo është e aplikueshme.

19.2 Ofruesi i shërbimeve të trajtimit në tokë dhe agjenti i trajtimit të mallrave duhet të mbajë shënime për të gjithë operatorët e aprovuar për transport të mallrave të rrezikshme përmes ajrit nga aeroporti në të cilin ofruesi i shërbimeve ushtron veprimtarinë e vet.

19.3 Ofruesi i shërbimeve të trajtimit në tokë dhe agjenti i trajtimit të mallrave duhet t'ia dorëzojë AACK-së shënimet e referuara në paragrafin 2 të këtij neni, sipas kërkesës.

## **Neni 20**

### **Transporti i mallrave të rrezikshme përmes postës**

20.1 Në përputhje me Konventën e Unionit Postar Universal (UPU), mallrat e rrezikshme të definuara në Instruksionet Teknike nuk lejohen në postë, përveç me anë të përjashtimit të atyre që janë listuar në paragrafin 2 të këtij neni . AACK duhet të sigurojë respektimin e dispozitave që lidhen me transportin e mallrave të rrezikshme përmes ajrit.

20.2 Mallrat e mëposhtme të rrezikshme mund të pranohen në postë për bartje përmes ajrit sipas dispozitave të Instruksioneve Teknike, të cilat kanë të bëjnë me materiale të tilla siç janë:

- a) mostrat e pacientëve siç janë definuar në nenin 2 të kësaj Rregulloreje me kusht që të jenë të klasifikuara, paketuara dhe shënuara në pajtim me dispozitat e Pjesës 2; 6.3.2.3.6 të Instruksioneve Teknike;
- b) substancat infektuese të ndara ekskluzivisht në kategorinë B (UN 3373), me kusht që të jenë të paketuara në përputhje me kërkesat e Instruksionit të Paketimit 650 dhe dioksidi i karbonit i ngurtë (akulli i thatë) kur përdoret si lëndë ftohëse për UN 3373;
- c) materiali radioaktiv, aktiviteti i të cilit nuk tejkalon një të dhjetën e atyre të listuar në Pjesën 2, Kapitulli 7, Tabela 2-15 të Instruksioneve Teknike;
- d) bateritë litium-joni që ndodhen në pajisjen (UN 3481) dhe përmbushin dispozitat e Seksionit II të Instruksioneve të Paketimit 967. Jo më shumë se katër qelia apo dy bateri mund të dërgohen përmes postës në një pako të vetme; dhe

- e) bateritë litiumi metalike të ndodhen në pajisjen (UN 3091) dhe përmbushin dispozitat e Seksionit II të Instruksioneve të Paketimit 970. Jo më shumë se katër qelia apo dy bateri mund të dërgohen përmes postës në një pako të vetme.

20.3 Procedurat e operatorëve të emëruar postar për kontrollin e futjes së mallrave të rrezikshme në postë për transport ajror i nënshtrohen rishikimit dhe aprovimit nga AACK.

20.4 Operatori i emëruar postar nuk guxon të pranojë mallra të rrezikshme të referuara në paragrafin 2, pika a), b) dhe c) të këtij neni, pa aprovim specifik të AACK-së.

20.5 Para se operatori i emëruar postar të mund të fillojë pranimin e baterive litiumi të referuara në paragrafin 2 pika d) dhe e) të këtij neni, ai duhet të marrë një aprovim të veçantë nga AACK.

## **Neni 21** **Deponimi**

21.1 Objektet për deponim duhet të dizajnohen në atë mënyrë që të mund të pranojnë dërgesat e mallrave të rrezikshme të destinuara për arritje/nisje, dërgesat e mallrave të rrezikshme për deponim të përkohshëm dhe dërgesat e dëmtuara të mallrave të rrezikshme, në hapësirat e përcaktuara për to.

21.2 Objektet për deponim duhet të jenë të pajisura me pajisje për fikjen e zjarrit dhe duhet të kenë procedura emergjente të paraqitura në vende të dukshme.

21.3 Dërgesat e mallrave të rrezikshme duhet të jenë të ndara nga dërgesat e mallrave tjera.

21.4 Dërgesat e mallrave të rrezikshme duhet të deponohen ose vendosen në hapësira të përcaktuara për to, të cilat duhet të jenë të shënuara siç duhet.

21.5 Dërgesat e dëmtuara të mallrave të rrezikshme duhet të deponohen në një hapësirë të ndarë.

21.6 Materiali radioaktiv duhet të deponohet ose vendoset në një hapësirë të përshtatshme, të rezervuar veçanërisht për këtë qëllim. Kjo hapësirë duhet të shënohet me pankarta të përshtatshme për materialin radioaktiv.

21.7 Materiali radioaktiv duhet të deponohet dhe ndahet duke ofruar distancë të duhur nga hapësira ku kanë qasje punonjësit dhe klientët në mënyrë që të zvogëlohet ekspozimi ndaj rrezatimit, sipas rekomandimeve të AKMRrSB e cila përcakton kushtet dhe standardet për deponim të përkohshëm të materialeve radioaktive në aeroporte.

21.8 Qasja në objektet për deponim duhet të jetë e kufizuar dhe vetëm personeli i trajnuar në mënyrë të duhur mund të trajtojë dërgesat e mallrave të rrezikshme.

## **Neni 22**

### **Ofrimi i informacioneve**

22.1 Operatori i mjetit ajror në të cilin mallrat e rrezikshme duhet të barten do t'i ofrojë pilotit komandues, sa më shpejtë që të jetë e mundur para nisjes së mjetit ajror, por në asnjë rast jo më vonë se kur mjeti ajror fillon të lëviz nën fuqinë vetanake, informata me shkrim siç specifikohet në Instruksionet Teknike.

22.2 Operatori duhet t'i japë personelit përgjegjës për kontrollin operacional të mjetit ajror (p.sh. zyrtari i operimeve të fluturimit, dispeçeri i fluturimit, ose personeli tokësor përgjegjës për operimet e fluturimeve) të njëjtat informata që kërkohet t'i jipen pilotit komandues (p.sh. një kopje e informacionit me shkrim që i jepet pilotit komandues). Çdo operator duhet të specifikojë personelin (titullin e punës apo funksionin) të cilëve i ofrohen këto informata në manualin e tyre të operimeve dhe/ose manualet tjera të përshtatshme.

22.3 Operatori duhet të sigurojë që publikimi i informacionit të bëhet në një mënyrë që udhëtarët të jenë paralajmëruar për llojet e mallrave të rrezikshme të cilat janë të ndaluara për t'u bartur në bord, siç kërkohet nga Instruksionet Teknike.

22.4 Një organizatë (operator ekonomik) ose një sipërmarrës, i cili nuk është operator (p.sh.: agjencitë e udhëtimit), që marrin pjesë në transportin e udhëtarëve përmes ajrit, duhet të japin informacionin për udhëtarët e vet mbi llojet e mallrave të rrezikshme të cilat janë të ndaluara për t'u bartur në bord. Si minimum, ky informacion duhet të jepet përmes njoftimit në ato vende ku udhëtarët vëjnë kontakt me ta.

22.5 Kur mundësohet që procesi i regjistrimit për nisje (check-in) të kryhet nga distanca (p.sh. nëpërmjet internetit), operatori duhet të sigurojë informacion mbi llojet e mallrave të rrezikshme të cilat udhëtarët nuk kanë të drejtë t'i transportojnë në bordin e një mjeti ajror. Informacioni i cili mund të jetë në formë të tekstit apo fotografisë, duhet të jetë i tillë që siguron se procesi i regjistrimit për nisje nuk mund të përfundojë deri në rastin kur udhëtari ose ndonjë person që vepron në emër të tyre, të mos ketë shfaqur shprehimisht se ka kuptuar kufizimet mbi mallrat e rrezikshme në bagazhin e udhëtarëve.

22.6 Kur mundësohet që procesi i regjistrimit për nisje (check-in) të kryhet në një aeroport nga një udhëtar pa përfshirjen e ndonjë personi tjetër (p.sh. pajisjet për regjistrim të automatizuar për nisje), Operatori ose operatori i aeroportit duhet të sigurojë informacionin mbi llojet e mallrave të rrezikshme të cilat udhëtarët e kanë të ndaluar t'i transportojnë në bordin e një mjeti ajror. Informacioni duhet të jetë në formë të fotografisë dhe duhet të jetë i tillë që procesi për regjistrim para nisjes të mos mund të përfundojë deri sa udhëtarët të kenë shfaqur shprehimisht se kanë kuptuar kufizimet mbi mallrat e rrezikshme në bagazhin e udhëtarëve.

22.7 Operatori apo agjenti i trajtimit i operatorit duhet të sigurojnë që njoftimet të cilat ofrojnë informacione në lidhje me transportin e mallrave të rrezikshme janë të mjaftueshme në numër, janë të ekspozuara dukshëm dhe ofrohen në vendin(et) e dukshëm në pikat e pranimit të mallrave për të paralajmëruar dërguesit/agjentët për çdo mall të rrezikshëm që mund të jetë i përfshirë në dërgesën(at) e tyre të ngarkesave. Këto njoftime duhet të përfshijnë shembuj vizual të mallrave të rrezikshme, duke përfshirë edhe bateritë.

22.8 Operatorët, transportuesit dhe subjektet tjera të përfshira në transportin e mallrave të rrezikshme përmes ajrit duhet të sigurojnë informata të tilla për personelin e tyre për t'iu mundësuar që të zbatojnë përgjegjësitë e tyre në lidhje me transportin e mallrave të rrezikshme dhe duhet të ofrojnë udhëzime lidhur me veprimet që duhet ndërmarrë në rast të emergjencave që shfaqen e që përfshijnë mallra të rrezikshme.

22.9 Nëse ndodhë ndonjë emergjencë në fluturim, piloti komandues duhet sa më shpejt që situata lejon, të informojë njësitë e duhura të shërbimeve të trafikut ajror, për të informuar autoritetet e aerodromit, mbi çfarëdo mallrash të rrezikshme në bord të mjetit ajror, siç është paraparë në Instruksionet Teknike.

22.10 Në rast të ndonjë aksidenti të mjetit ajror, operatori i mjetit ajror që ka bartur mallra të rrezikshme si ngarkesë duhet të ofrojë informata pa vonesë, me rastin e raportimit të aksidentit ndaj agjencisë përgjegjëse për hetim të aksidenteve të shtetit në fjalë, ndaj asaj agjencie dhe ndaj personelit të emergjencës që i përgjigjet aksidentit lidhur me mallrat e rrezikshme në bord, siç ofrohet në informacionin me shkrim për Pilotin komandues.

22.11 Në rast të një incidenti të mjetit ajror, operatori i mjetit ajror që bartë mallra të rrezikshme, sipas kërkesës, do të japë informata pa vonesë, me rastin e raportimit të aksidentit ndaj agjencisë përgjegjëse për hetim të aksidenteve të shtetit në fjalë, ndaj asaj agjencie dhe ndaj personelit të emergjencës që i përgjigjet incidentit lidhur me mallrat e rrezikshme në bord, siç ofrohet në informacionin me shkrim për Pilotin komandues.

## **Neni 23**

### **Certifikimi i ofruesve të trajnimit**

23.1 Ofruesi i trajnimit është një organizatë që ka personel adekuat, pajisje, vepron në një mjedis të duhur dhe që kryen trajnimin teorik në përputhje me programin e trajnimit të aprovuar nga AACK.

23.2 Një organizatë që ka për qëllim që të kryej trajnime për mallrat e rrezikshme duhet të aprovohet nga AACK. Formulari i aplikimit për certifikimin e ofruesit të trajnimeve (në dispozicion në faqen e internetit të AACK-së) duhet të përfshijë si në vijim:

- a) formën e aplikimit për lëshimin e certifikatës për ofruesin e trajnimit;

- b) përshkrimin e strukturës organizative;
- c) listën e kualifikimeve të personelit udhëheqës dhe të instruktorëve;
- d) përshkrimin e klasave dhe objekteve të tjera;
- e) përshkrimin e programit të trajnimit, duke përfshirë manualët, kurrikulën, oraret dhe materialet mësimore;
- f) përshkrimin e sistemit për sigurimin e cilësisë.

23.3 Ofruesi i trajnimit do të sigurojë kushtet minimale teknike dhe higjienike të objekteve në të cilat trajnimi kryhet në përputhje me rregulloret në fuqi për arsimin.

23.4 Ofruesi i trajnimit do të sigurojë që instruktorët pranojnë ndryshimet e fundit të Instruksioneve Teknike dhe/ose botimet e reja të Rregulloreve të IATA-së mbi Mallrat e Rrezikshme dhe materialet e trajnimit.

23.5 Ofruesi i trajnimit do të:

- a) krijojë programe të trajnimit siç është specifikuar në Instruksionet Teknike, që vlejné për kategori të ndryshme të personelit;
- b) sigurojë që programi i trajnimit është në përputhje me programin e trajnimit për mallrat e rrezikshme i aprovuar nga AACK;
- c) paraqesë kërkesën për aprovimin e programit të trajnimit çdo dy vjet, me çdo botim të ri të Instruksioneve Teknike;
- d) sigurojë që trajnimi është kryer nga instruktorë kompetentë;
- e) krijojë programe për trajnimin fillestar dhe periodik me qëllimet e përcaktuara;
- f) sigurojë mbulimin e të gjitha temave relevante në mënyrë që të përmbushë objektivat e trajnimit;
- g) ofrojë njohuri të detajuara në mënyrë që të sigurohet që trajnimi është i përshtatshëm për detyrat dhe përgjegjësitë e pjesëmarrësve;
- h) përfshijë një pjesë të caktuar të përmbajtjes si pjesë të materialeve mësimore të shpërndara, shënimeve, ushtrimeve, etj, në mënyrë që të plotësohen kërkesat minimale të trajnimit sipas Instruksioneve Teknike;
- i) përcaktojë kohëzgjatjen e programit të trajnimit bazuar në përvojën e pjesëmarrësve njohuritë e tyre të mëparshme dhe faktorë të tjerë, si dhe mirëmbajë nivelin e kërkuar të dijes;

- j) aprovojë programin e trajnimit periodik në përputhje me ndryshimet e fundit dhe kërkesat e industrisë;
- k) sigurojë trajnim periodik brenda afateve kohore të përcaktuara në Instruksionet Teknike;
- l) vlerësojë njohuritë e pjesëmarrësve në fund të seancës trajnuese, me një provim me pyetje të qarta dhe koncize;
- m) sigurojë që provimi nuk është një testim i kujtesës, por më tepër përdorim i rregulloreve dhe literaturës gjatë provimit;
- n) përcaktojë kohëzgjatjen e nevojshme të provimit në mënyrë precize;
- o) lëshojë certifikata si dëshmi mbi përfundimin e suksesshëm të provimit;
- p) mbajë shënime të plota të trajnimit me të gjitha informatat e nevojshme;
- q) mbajë të dhënat e trajnimit fillestar dhe periodik siç specifikohet në Instruksionet Teknike;
- r) përdorë Instruksionet Teknike si burim i vetëm autentik rregullator për trajnimin, dhe
- s) në qoftë se botimi i fundit i Rregullores së IATA-s për mallrat e rrezikshme përdoret për trajnimin, atëherë duhet të bëhet një krahasim me kërkesat e detyrueshme të Instruksioneve Teknike.

## **Neni 24**

### **Pezullimi ose revokimi i certifikatës së ofruesve të trajnimit**

24.1 AACK pezullon përkohësisht certifikatën e lëshuar për ofruesin e trajnimit, nëse ofruesi:

- a) nuk i plotëson më kushtet e përcaktuara, ose
- b) nuk arrin të mbajë të azhurnuara programet e trajnimit, ose
- c) nuk bashkëpunon sa duhet në lidhje me gjetjet e AACK-së dhe afatet e dhëna për eliminimin e jo-pajtueshmërive.

24.2 AACK revokon certifikatën e lëshuar për ofruesin e trajnimit, kur:

- a) kërkohet nga mbajtësi i certifikatës, ose

- b) mbajtësi i certifikatës kryen veprimtari të cilat kërkojnë aprovim tjetër, i cili nuk është marrë, ose
- c) mbajtësi i certifikatës nuk arrin të ofrojë dëshmi për eliminimin e gjetjeve që kanë shpër në pezullimin e përkohshëm të certifikatës, apo
- d) mbajtësi i certifikatës me dashje ose nga pakujdesia i ka dorëzuar AACK-së informacion të pasaktë për çështje të rëndësishme.

## **Neni 25**

### **Programet e trajnimit**

25.1 Ofruesit e trajnimit do të vendosin dhe mirëmbajnë programe fillestare dhe periodike të trajnimit për mallra të rrezikshme për:

- a) transportuesit e mallrave të rrezikshme, duke përfshirë paketuesit dhe personat ose subjektet që marrin përsipër përgjegjësitë e transportuesit të mallrave;
- b) operatorët;
- c) agjencitë e trajnimit në tokë që në emër të operatorit kryejnë pranimin, trajtimin, ngarkimin, shkarkimin, transferimin ose përpunimin tjetër të ngarkesave apo postës;
- d) agjencitë e trajnimit në tokë të vendosur në aeroport, të cilët në emër të operatorit kryejnë procesimin e udhëtarëve;
- e) agjencitë, që nuk janë të vendosura në aeroport, që kryejnë në emër të operatorit regjistrimin për nisje të udhëtarëve;
- f) shpeditërit;
- g) agjencitë e angazhuara në kontrollin e sigurimit të udhëtarëve, bagazhit të tyre dhe/ose ngarkesës apo furnizimeve; dhe
- h) operatorët postar të emëruar.

25.2 Trajnimi dhe vlerësimi i kompetencës kryhet në përputhje me dispozitat e përgjithshme të përfshira në Kapitullin 2 të Procedurave të ICAO-s për Shërbimet e Navigacionit Ajror - Trajnimi (PANS-TRG; Doc 9868).

25.3 Personeli duhet të trajnohet mbi kërkesat proporcionalisht me përgjegjësitë e tyre. Personeli i identifikuar në kategoritë e specifikuar në Tabelën 1, 2 ose 3 duhet të jetë

i trajnuar ose trajnimi duhet të verifikohet para se personi të kryej ndonjë detyrë të përcaktuar në tabelën 1, 2 ose 3.

25.4 Trajnimi periodik duhet të ofrohet brenda 24 muajve pas trajnimit të kaluar për t'u siguruar që njohuritë mbesin aktuale. Megjithatë, në qoftë se trajnimi periodik është përfunduar brenda tre muajve të fundit të vlefshmërisë së trajnimit të kaluar, periudha e vlefshmërisë shtrihet nga muaji në të cilin trajnimi periodik është përfunduar deri në 24 muaj nga muaji i skadimit të trajnimit të mëparshëm.

25.5 Personeli i Sigurimit duhet të jetë trajnuar në përputhje me Instruksionet Teknike pavarësisht nëse operatori përmes së cilit udhëtarët ose ngarkesat duhet të transportohen bart mallra të rrezikshme si ngarkesë.

25.6 Programet e trajnimit të mallrave të rrezikshme të kërkuara sipas paragrafit 1, pika b) dhe h) të këtij neni do ti nënshtrohen rishikimit dhe aprovimit nga AACK.

25.7 Programet e trajnimit të mallrave të rrezikshme të kërkuara nga të tjerët prej atyre nga paragrafi 1, pika b) dhe h) të këtij neni duhet t'i nënshtrohen rishikimit dhe aprovimit nga AACK.

25.8 Formulari i aplikimit për aprovimin e programit të trajnimit për mallrat e rrezikshme që është referuar në paragrafin 5 dhe 6 të këtij neni, është në dispozicion në faqen e internetit.

25.9 Çështjet në lidhje me transportin e mallrave të rrezikshme me të cilat kategoritë e ndryshme të personelit duhet të jenë të njoftuara, janë paraqitur në Tabelën 1.

25.10 Personeli i operatorëve që nuk bartin mallra të rrezikshme si ngarkesa ose postë do të trajnohet në përputhje me përgjegjësitë e tyre. Çështjet me të cilat kategoritë e tyre të ndryshme të personelit duhet të jenë të njoftuara janë paraqitur në Tabelën 2.

25.11 Personeli i operatorëve postar të emëruar do të trajnohet në përputhje me përgjegjësitë e tyre. Çështjet me të cilat kategoritë e tyre të ndryshme të personelit duhet të jenë të njoftuara janë paraqitur në Tabelën 3.

**Tabela 1 - Përmbajtja e kurseve të trajnimit për operatorët që bartin mallra të rrezikshme si ngarkesë apo postë**

Aspektet minimale të transportit të mallrave të rrezikshme përmes ajrit me të cilat ata duhet të jenë të familjarizuar	Dërguesit dhe paketuesit		Shpeditëret			Operatorët dhe agjentët e trajtimit në tokë						Personeli i sigurimit	
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11		12
Filozofia e përgjithshme	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X
Kufizimet	X		X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X
Kërkesat e përgjithshme për dërguesit	X		X			X							
Klasifikimi	X	X	X			X							X
Lista e mallrave të rrezikshme	X	X	X			X				X			
Kërkesat për paketim	X	X	X			X							



Etiketimi dhe shënjimi	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X
Dokumenti i transportit të mallrave të rrezikshme dhe dokumentet tjera relevante	X		X	X		X	X						
Procedurat e pranimit						X							
Njohja e mallrave të rrezikshme të padeklaruara	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X
Procedurat e deponimit dhe ngarkimit					X	X		X		X			
Njoftimi i pilotëve						X		X		X			
Dispozitat për udhëtarët dhe ekuipazhin	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X
Procedurat për rastet emergjente	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X

## KATEGORIA

1. Dërguesit dhe personat që marrin përsipër përgjegjësitë e dërguesve
2. Paketuesit
3. Personeli i shpeditereve i përfshirë në procesimin e mallrave të rrezikshme
4. Personeli i shpeditereve i përfshirë në procesimin e ngarkesave ose postës (përveç mallrave të rrezikshme)
5. Personeli i shpeditereve i përfshirë në trajtimin, deponimin dhe ngarkimin e ngarkesave ose postës
6. Personeli i operatorëve dhe agjentëve të trajtimit në tokë që pranon mallrat e rrezikshme
7. Personeli i operatorëve dhe agjentëve të trajtimit në tokë që pranon ngarkesat ose postën (përveç mallrave të rrezikshme)
8. Personeli i operatorëve dhe agjentëve të trajtimit në tokë i përfshirë në trajtimin, deponimin dhe ngarkimin e ngarkesave ose postës dhe bagazhit
9. Personeli i shërbimit të udhëtarëve
10. Anëtarët e ekuipazhit të fluturimit, mbikëqyrësit e ngarkesës dhe planifikuesit e ngarkimit
11. Anëtarët e ekuipazhit (përveç anëtarëve të ekuipazhit të fluturimit)
12. Personeli i sigurimit i cili është i përfshirë në skenimin e udhëtarëve dhe bagazhit të tyre si dhe të ngarkesave ose postës, p.sh. skenuesit e sigurimit, mbikëqyrësit e tyre dhe personeli i përfshirë në implementimin e procedurave të sigurimit

**Tabela 2 - Përmbajtja e kurseve trajnuese për operatorët që nuk bartin mallra të rrezikshme si ngarkesë apo postë**

Përmbajtja	7	8	9	10	11
Filozofia e përgjithshme	X	X	X	X	X
Kufizimet	X	X	X	X	X
Etiketimi dhe shënjimi	X	X	X	X	X
Dokumenti i transportit të mallrave të rrezikshme dhe dokumentet tjera relevante	X				
Njohja e mallrave të rrezikshme të padeklaruara	X	X	X	X	X
Dispozitat për udhëtarët dhe ekuipazhin	X	X	X	X	X
Procedurat për rastet emergjente	X	X	X	X	X

## KATEGORIA

7. Personeli i operatorëve dhe agjentëve të trajtimit në tokë që pranon ngarkesat ose postën (përveç mallrave të rrezikshme)
8. Personeli i operatorëve dhe agjentëve të trajtimit në tokë i përfshirë në trajtimin, deponimin dhe ngarkimin e ngarkesave ose postës dhe bagazhit
9. Personeli i shërbimit të udhëtarëve
10. Anëtarët e ekuipazhit të fluturimit, mbikëqyrësit e ngarkesës dhe planifikuesit e ngarkimit
11. Anëtarët e ekuipazhit (përveç anëtarëve të ekuipazhit të fluturimit)

**Tabela 3 - Përmbajtja e kurseve trajnuese për personelin e operatorëve të emëruar postar**

Aspektet minimale të transportit të mallrave të rrezikshme përmes ajrit me të cilat ata duhet të jenë të familjarizuar	Operatorët e emëruar postar		
	A	B	C
Filozofia e përgjithshme	X	X	X
Kufizimet	X	X	X
Kërkesat e përgjithshme për dërguesit	X		
Klasifikimi	X		
Lista e mallrave të rrezikshme	X		
Kërkesat për paketim	X		
Etiketimi dhe shënjimi	X	X	X
Dokumenti i transportit të mallrave të rrezikshme dhe dokumentet tjera relevante	X	X	
Pranimi i mallrave të rrezikshme të listuara në Pjesën 1;2.3.2 të IT	X		
Njohja e mallrave të rrezikshme të padeklaruara	X	X	X
Procedurat e deponimit dhe ngarkimit			X
Dispozitat për udhëtarët dhe ekuipazhin	X	X	X
Procedurat për rastet emergjente	X	X	X

**KATEGORIA**

- A. Personeli i operatorëve të emëruar postar i përfshirë në pranimin e postës që përmban mallra të rrezikshme
- B. Personeli i operatorëve të emëruar postar i përfshirë në procesimin e postës (përveç mallrave të rrezikshme)
- C. Personeli i operatorëve të emëruar postar i përfshirë në trajtimin, deponimin dhe ngarkimin e postës

## Neni 26

### Testimi

26.1 Pjesëmarrësi duhet të demonstrojë nivelin e tij/saj të kompetencës duke kaluar me sukses provimin në fund të programit të trajnimit. Testi do të konfirmojë të kuptuarit e pjesëmarrësve si dhe aftësinë për të aplikuar informacionet e nevojshme nga Instruksionet Teknike.

26.2 Marrja në pyetje do të jetë e tillë që do të përcaktojë aftësinë e pjesëmarrësit për të kryer përgjegjësitë e tij/saj të veçanta të punës në përputhje me rregulloret në fuqi.

26.3 Kohëzgjatja e provimit do të sigurojë kohë të mjaftueshme për pjesëmarrësin për të lejuar atë për të përfunduar provimin, bazuar në nivelin e përvojës dhe fushën e trajnimit.

26.4 Materiali testues do të përmbajë një shpjegim hyrës për pjesëmarrësit duke deklaruar që nota kaluese do të jetë së paku 80% të përgjigjeve të sakta.

## Neni 27

### Shënimet e trajnimit

27.1 Ofruesi i trajnimit duhet të mbajë shënimet që përmbajnë:

- a) emrin dhe mbiemrin e pjesëmarrësit;
- b) muajin e përfundimit të trajnimit të fundit të mbajtur;
- c) përshkrimin dhe kopjen e materialeve të mësimdhënies apo referenca të dokumenteve të përdorura në trajnimin në përputhje me kërkesat e trajnimit;
- d) emrin dhe adresën e ofruesit të trajnimit;
- e) dëshmi që tregojnë që testi është kaluar në mënyrë të suksesshme.

27.2 Të dhënat e trajnimit do të mbahen për së paku 36 muaj pas përfundimit të trajnimit të fundit të mbajtur.

27.3 Të dhënat e trajnimit do të jenë në dispozicion të AACK-së sipas kërkesës.

## **Neni 28**

### **Certifikatat e testimit**

28.1 Ofruesi i trajnimit do të lëshojë certifikata të provimit.

28.2 Certifikata duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm, në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, duke përfshirë edhe gjuhën angleze si shtesë:

- a) *Emri i ofruesit të trajnimit;*
- b) *Numri i regjistrimi të pjesëmarrësit;*
- c) *Lloji i trajnimit;*
- d) *Kategoria e personelit;*
- e) *Dispozita e rregullorës së zbatueshme;*
- f) *emri dhe mbiemri i pjesëmarrësit, i ndjekur nga deklarata*
- g) *"Ka kaluar kursin";*
- h) *Vendi dhe data e lëshimit;*
- i) *Data e skadimit;*
- j) *Emri dhe mbiemri i instruktor;*
- k) *Nënshkrimi i instruktorit;*

*l) Emri dhe mbiemri i Udhëheqësit të ofruesit të trajnimit;*

*m) Nënshkrimi i Udhëheqësit të Ofruesit të trajnimit dhe vula zyrtare;*

28.3 Kopjet e certifikatave të lëshuara nga ofruesi i trajnimit do të mbahen së bashku me të dhënat e trajnimit.

28.4 Operatorët dhe ofruesit e shërbimeve të trajtimit në tokë që kryejnë në emër të operatorit, pranimin, trajtimin, ngarkimin, shkarkimin, transferimin ose përpunimin tjetër të ngarkesave ose postës do t'i dorëzojnë AACK-së kopjet e certifikatave të vlefshme për personelin e tyre që kanë ndjekur dhe me sukses kanë dhënë provimin për Kategorinë 6 të kursit të trajnimit.

28.5 Transportuesit dhe shpediterët që marrin përsipër përgjegjësitë e transportuesve, paketuesve dhe operatorëve që veprojnë si transportues, do t'i dorëzojnë AACK-së kopjet e certifikatave të vlefshme për personelin e tyre që kanë ndjekur dhe me sukses kanë dhënë provimin për Kategoritë 1, 2 dhe 3 të kursit të trajnimit.

28.6 AACK mban të dhënat e paketuesve, transportuesve, shpediterëve që marrin përsipër përgjegjësitë e transportuesve, operatorëve dhe personelit të ofruesve të shërbimeve të trajtimit në tokë, siç referohen në paragrafin 4 dhe 5 të këtij neni.

## **Neni 29**

### **Numrat e regjistrimit të pjesëmarrësve**

29.1 Certifikatat e lëshuara për pjesëmarrësit e suksesshëm do të mbajnë numrat e regjistrimit të pjesëmarrësve. Numri duhet të jetë unik për çdo certifikatë.

29.2 Ofruesi i trajnimit do të aplikojë pranë AACK-së duke përdorur formularin e aplikimit për alokimin e numrave të regjistrimit të pjesëmarrësve i cili është në dispozicion në faqen e internetit.

29.3 AACK-ë mban të dhënat e numrit të regjistrimit të pjesëmarrësve, duke deklaruar numrat dhe emrat që i janë akorduar ofruesve të trajnimit.

## **Neni 30**

### **Kualifikimet e instruktorëve**

30.1 Instruktorët të cilët ligjërojnë programet fillestare dhe periodike të trajnimit për mallra të rrezikshme, si minimum, duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

- a) njohuri aktuale të Instruksioneve Teknike (ose Rregulloreve të IATA-s mbi mallrat e rrezikshme). Instruktorët duhet të ketë përfunduar me sukses Kategorinë 6 të programit të trajnimit për mallrat e rrezikshme,
- b) njohuri aktuale të rregulloreve kombëtare mbi transportin e mallrave të rrezikshme përmes ajrit,
- c) aftësi për të përgatitur plane të ligjëratave, materiale për lexim, ushtrime dhe provime. Instruktorët duhet të përfundojnë me sukses një kurs mbi teknikat e mësimdhënies,
- d) minimum pesë (5) vite përvojë pune me mallra të rrezikshme dhe operimeve në siguri dhe/ose përvojë në operimet e ngarkesave, duke përfshirë pranimin dhe trajtimin e mallrave të rrezikshme.

30.2 Instruktorët që ligjërojnë programet fillestare dhe periodike të trajnimit mbi mallrat e rrezikshme duhet të paktën çdo 24 muaj të ofrojnë kurse të tilla, ose në mungesë të kësaj të marrin pjesë në trajnim periodik.

30.3 Instruktorët duhet të marrin dhe kuptojnë informacionet e fundit mbi mallrat e rrezikshme dhe të jenë të vetëdijshëm për këto ndryshime përmes trajnimit apo mjeteve të tjera, në baza vjetore, ose kur rregulloret e zbatueshme ndryshojnë.

30.4 Instruktorët duhet të informojnë AACK-në në lidhje me kurset e trajnimit që janë kryer. Raporti duhet të dorëzohet në fillim të vitit kalendarik për vitin e kaluar dhe duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

- a) Emri dhe mbiemri i instruktor;
- b) Emri i ofruesit të trajnimit;
- c) Lloji i trajnimit;
- d) Kategoria e personelit;
- e) Numri i pjesëmarrësve; dhe
- f) Data(t) dhe vendi i trajnimit.

30.5 AACK-ë duhet të mbajë shënimet e instruktorëve që janë të pranuar dhe të cilët vazhdojnë t'i plotësojnë kërkesat për të kryer trajnimin për mallra të rrezikshme. Forma e aplikimit për pranim të instruktorit për Mallra të rrezikshme është në dispozicion në faqen e internetit.

## Neni 31

### Trajnimi i bazuar në kompjuter (CBT) / dhe mësimi përmes internetit (E-learning)

31.1 Ofruesi i trajnimit asnjëherë nuk do të përjashtojë tërësisht instruktorët gjatë kryerjes së trajnimit të mallrave të rrezikshme. Përdorimi i metodës së përzier të trajnimit është metoda më e përshtatshme për përmbushjen e kërkesave rregullatore.

31.2 Për të qenë në gjendje për të kryer trajnime duke përdorur CBT dhe/ose mësimin përmes internetit, ofruesit e trajnimit do të:

- a) tregojnë të mirat e ofrimit të trajnimit duke përdorur CBT dhe/ose mësimin përmes internetit;
- b) sigurojnë përputhjen në lidhje me kërkesat për trajnim të përcaktuara në Instruksionet Teknike dhe që nuk ka tema që janë më pak të përfaqësuar dhe/ose të lëna pas dore;
- c) sigurojnë disponueshmërinë e manualit që përmban Rregulloret e Mallrave të Rrezikshme dhe referencat e përditësuara;
- d) marrë masat e duhura që pjesëmarrësit me motivim të ulët për mësim nuk mbeten prapa në procesin e të nxënit;
- e) mbikëqyrë trajnimin duke u siguruar që pjesëmarrësit nuk janë të hutuar në lidhje me aktivitetet e vazhdueshme dhe afatet kohore;
- f) sigurojnë që instruktorët e kualifikuar për trajnimin fillestar dhe periodik, të pranuar nga AACK, ndihmojnë pjesëmarrësit të cilët janë të hutuar ose që mund të kenë nevojë për ndihmë;
- g) ofrojnë lidhje të internetit me shpejtësi të lartë për qasje në materiale të mësimit për pjesëmarrësit;
- h) sigurojnë që dosjet e CBT dhe të programeve të mësimit përmes internetit nuk janë komplekse për pjesëmarrësit me aftësi bazike në punë me kompjuter;
- i) sigurojnë që temat të cilat janë të vështira për t'u simuluar në një klasë, menaxhohen nën drejtimin dhe sqarimin e instruktorëve;
- j) inspektojnë:
  - kompjuterët e lidhur në rrjet,
  - laptopët,
  - kompjuterët personal,
  - pajisjet tjera dixhitale (p.sh. asistentët personal dixhital dhe telefonat e mençur),

- materialet për lexim dhe materialet referuese;
- k) sigurojë që të gjitha të dhënat që vërtetojnë mbarimin e trajnimit mund të paraqiten pas kërkesës dhe janë në dispozicion në formë të shtypur; dhe
- l) marrë aprovimin paraprak nga AACK-ë për CBT dhe/ose trajnimin e bazuar në mësim përmes internetit.

## **Neni 32**

### **Ruajtja e dokumenteve dhe shënimeve**

32.1 Operatori i mjetit ajror do të sigurojë që të paktën një kopje e dokumentit të një dërgese të mallrave të rrezikshme e përshtatshme për transportin përmes ajrit është mbajtur për një periudhë minimale prej tre muajsh pas fluturimit në të cilin janë transportuar mallrat e rrezikshme.

32.2 Si minimum, dokumentet të cilat duhet të ruhen janë:

- a) dokumentet e transportit të mallrave të rrezikshme;
- b) lista e plotë e pranimit (kur kjo është në një formë e cila kërkon plotësimin fizik);
- c) informatat me shkrim për pilotin komandues.

32.3 Për çdo paketim dhe/ose mbi-paketim dhe/ose mbajtës të mallrave dhe/ose pajisje për ngarkim të njësisë dhe/ose palete, që përmban mallra të rrezikshme, e cila nuk është pranuar për transport përmes ajrit, për shkak të ndonjë gabimi ose dështimi të transportuesit lidhur me paketimin, shënjimin, etiketimin dhe dokumentacionin e pasaktë ose jo të plotë, një kopje e dokumentit të transportit dhe listat kontrolluese duhet të mbahen për një periudhë minimale prej tre muajsh pas plotësimit të listës së pranimit.

32.4 Dërguesi do të mbajë dokumente mbi transportin e mallrave të rrezikshme përmes ajrit për të paktën tre muaj pas fluturimit.

## **Neni 33**

### **Dorëzimi i dokumenteve, shënimeve dhe raporteve mujore**

33.1 Operatori i mjetit ajror në të cilin mallrat e rrezikshme do të transportohen ose janë transportuar duhet, brenda një kohe të arsyeshme pasi që kjo kërkohet nga inspektori, të paraqesë dokumentet e mëposhtme:

- a) aprovimin me shkrim për transportin e mallrave të rrezikshme përmes ajrit;
- b) dokumentin e transportit të mallrave të rrezikshme;

- c) listën kontrolluese të plotësuar në mënyrë të përshtatshme për mallrat e rrezikshme, dhe
- d) kopjen e informacionit me shkrim që i është dorëzuar pilotit komandues.

33.2 Në rastet kur ekziston dyshimi i arsyeshëm që mallrat e rrezikshme nuk janë trajtuar në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje dhe Instruksionet Teknike, operatori, transportuesi i mallrave, shpeditoret e mallrave ose ofruesit e shërbimeve të trajtimit në tokë, brenda një kohe të arsyeshme, pasi u kërkohet të bëjnë një gjë të tillë nga Inspektori, i'a paraqesin atij dokumentin.

33.3 Operatorët dhe ofruesit e shërbimeve të trajtimit në tokë duhet t'i paraqesin AACK-së një raport mujor me shkrim. Forma e raportit për transportin e mallrave të rrezikshme përmes ajrit është në dispozicion në faqen e internetit..

#### **Neni 34** **Mekanizmat e përputhshmërisë dhe zbatimit**

34.1 Në përputhje me përgjegjësitë e përcaktuara në Ligjin për Aviacionin Civil (Ligji Nr. 03/L-051), dhe Rregulloren mbi autorizimet dhe kredencialet e inspektorëve (Rregullorja Nr. 08/2011), inspektorët janë përgjegjës për kryerjen e funksioneve mbikëqyrëse të të gjitha subjekteve dhe individëve që janë në çfarëdo mënyre të përfshirë në transportin e mallrave të rrezikshme përmes ajrit lidhur me nënshtrimin ndaj dispozitave të kësaj rregulloreje, Instruksioneve Teknike dhe legjislacionit tjetër që përmbanë dispozita në lidhje me transportin e mallrave të rrezikshme përmes ajrit.

34.2 Inspektori mund të kërkojë dhe t'i lejohet qasje e papenguar në çdo mjet ajror, aerodrom, objekte, struktura të saj, pajisje dhe mjete, si dhe në dokumente, duke përfshirë certifikatat, manualët, regjistrat dhe të dhënat e çdo subjekti të inspektuar ose audituar që janë listuar në nenin 1.2 të kësaj rregulloreje, të marrin mostra dhe konfiskojnë mallra të rrezikshme për të cilat ekziston dyshimi i arsyeshëm që nuk janë trajtuar në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje, Instruksionet Teknike dhe legjislacionin tjetër që përmbanë dispozita në lidhje me transportin e mallrave të rrezikshme përmes ajrit.

34.3 Inspektori mund të hapë apo të kërkojë hapjen e çfarëdo bagazhi apo paketimi për të cilat ekziston dyshimi i arsyeshëm se ato mund të përmbajnë mallra të rrezikshme të cilat nuk janë trajtuar në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje, Instruksionet Teknike dhe çfarëdo dispozite tjetër që përmbanë dispozita në lidhje me transportin e mallrave të rrezikshme përmes ajrit.

34.4 Inspektori mund të:

- a) shqyrtojë dokumentet, të dhënat, procedurat dhe materialet tjera të ndërlidhura me të brenda fushës së certifikimit dhe/ose funksioneve të mbikëqyrjes;



- b) kopjoj dosje ose pjesë të dosjeve, të dhëna, procedura dhe materiale të tjera;
- c) kërkojë shpjegime verbale në vend;
- d) kryej auditime, hetime, vlerësime, inspektime, duke përfshirë inspektimet në platformë dhe inspektimet e paparalajmëruara, dhe
- e) ndërmarrë masa të zbatimit për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat.

34.5 Inspektori mund të kërkojë ndihmën e zyrtarëve publik/autoriteteve tjera dhe strukturat e policisë, në qoftë se hasë në një sulm, refuzim për të dorëzuar ose në qoftë se ndonjë rast i tillë me arsye pritet nga çfarëdo personi gjatë zbatimit të autorizimeve të parashikuara sipas paragrafi 2, 3 dhe 4 të këtij neni.

34.6 Shkelja e dispozitave të kësaj Rregulloreje, Instruksioneve Teknike dhe çfarëdo dispozitave tjera që përmbajnë dispozita në lidhje me transportin e mallrave të rrezikshme përmes ajrit do t'i nënshtrohet dispozitave ndëshkuese në bazë të Ligjit për Aviacionin Civil.

34.7 Pavarësisht nga paragrafi 6 i këtij neni, shkelja e dispozitave të kësaj Rregulloreje mund të përbëjë përgjegjësi penale në pajtim me dispozitat përkatëse të Ligjit për Aviacionin Civil dhe Kodin Penal të Republikës së Kosovës.

### **Neni 35**

#### **Raportimi i ndodhive me mallrat e rrezikshme**

35.1 Transportuesi i mallrave, shpediteri, doganat, operatori i caktuar i postës, ofruesi i shërbimit të trajtimit në tokë, agjenti për trajtimin e ngarkesave, operatori dhe të gjitha entitetet tjera vendi i biznesit kryesor i të cilëve është i vendosur në Republikën e Kosovës, ku mallrat e rrezikshme janë të pranishme në kohën e ndodhisë, pa marrë parasysh nëse mallrat e rrezikshme janë të vendosura në ngarkesë, postë ose bagazh, duhet t'i nënshtrohen kërkesave të raportimit të përcaktuara në këtë Rregullore si dhe duhet të informojnë AACK-në.

35.2 Operatori duhet të njoftojë autoritetin kompetent tek i cili mjeti ajror është i regjistruar dhe shtetin e origjinës mbi ndonjë ndodhi kur:

- a) është gjetur se mallrat e rrezikshme nuk janë ngarkuar, vendosur, ndarë dhe siguruar në përputhje me dispozitat e Instruksioneve Teknike.
- b) është zbuluar se mallrat e rrezikshme janë duke u transportuar dhe Piloti komandues nuk ka marrë informacion me shkrim në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulloreje dhe Instruksioneve Teknike.

35.3 Raporti fillestar duhet të dorëzohet brenda 72 orëve pas shfaqjes së ndodhisë, përveç nëse rrethana të jashtëzakonshme e parandalojnë këtë. Raporti mund të dërgohet duke përdorur mjete komunikimi elektronik apo nëpërmes telefonit ose faksit. Raporti duhet të përmbajë informacionin e përmendur në paragrafin 4 të këtij neni, edhe në qoftë se i gjithë informacioni nuk është në dispozicion. Kur është e nevojshme, dhe sa më shpejt të jetë e mundur, raporti plotësues do të dërgohet me informata shtesë që nuk kanë qenë të njohura në kohën kur është dorëzuar raporti fillestar. Nëse raporti është transmetuar gojarisht, konfirmimi me shkrim duhet të dorëzohet sa më shpejt të jetë e mundur.

35.4 Raporti fillestar dhe çdo raport i radhës do të përmbajë detaje sa më shumë të jetë e mundur dhe të përfshijë informacionin e mëposhtëm:

- a) datën dhe orën e paraqitjes;
- b) vendndodhjen e ndodhisë, datën e fluturimit dhe numrin e fluturimit;
- c) përshkrimin e ndodhisë;
- d) numrin referencë të itinerarit ajror apo qesen e korierit ose bagazhin apo biletën e udhëtarëve;
- e) emrin e duhur të dërgesës (duke përfshirë emrin teknik) dhe numrin e KB-së /të identifikimit (kur është i njohur);
- f) klasin/ndarjen dhe rrezikun vartës;
- g) llojin e paketimit dhe shënjmin specifik të paketimit;
- h) sasinë;
- i) emrin dhe adresën e transportuesit, agjentit, udhëtarëve, etj;
- j) informatat tjera përkatëse;
- k) shkakun e dyshuar dhe veprimet e ndërmarra;
- l) çdo raportim tjetër të mëparshëm (nëse janë bërë); dhe
- m) emrin, titullin, adresën dhe numrin e telefonit të personit që ka paraqitur raportin.

35.5 Kopjet e të gjitha dokumenteve relevante dhe çdo fotografi duhet të jetë e bashkangjitur me raportin.

35.6 Forma për raportim të ndodhive për mallrat e rrezikshme është në dispozicion në faqen e internetit.

## **Neni 36**

### **Dispozitat e sigurimit për mallrat e rrezikshme**

Ministria e Punëve të Brendshme, në cilësinë e vet si autoriteti përgjegjës për zhvillimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e programit kombëtar të sigurimit të aviacionit civil në Republikën e Kosovës vendos masa të sigurisë për mallrat e rrezikshme, që zbatohen për transportuesit, shpeditërit e mallrave, ofruesit e shërbimeve të trajtimit në tokë, agjentët e trajtimit të ngarkesave, operatorët postar të emëruar, operatorët dhe individët e tjerë të angazhuar në transportin e mallrave të rrezikshme përmes ajrit, për të minimizuar vjedhjen apo keqpërdorimin e mallrave të rrezikshme që mund të rrezikojnë personat, pronën apo mjedisin. Këto masa duhet të jenë në proporcion me dispozitat e sigurimit (mbrojtjes nga nderhyrjet e paligjshme) të përcaktuara në anekset tjera të ICAO-s dhe Instruksioneve Teknike.

## **Neni 37**

### **Dispozitat kalimtare**

37.1 Transportuesit, shpeditërit e mallrave, ofruesit e shërbimeve të trajtimit në tokë, agjentët e trajtimit të mallrave dhe operatorët që nuk kanë Certifikatë për operim ajror (AOC) të lëshuar dhe që nuk veprojnë në përputhje me kërkesat e Aneksit III të Rregullores (EEC) 3922/91 (të EU-OPS), duhet t'i zbatojnë plotësisht dispozitat e kësaj rregulloreje, dhe për të vazhduar me kryerjen e aktiviteteve që lidhen me transportin e mallrave të rrezikshme përmes ajrit, do të zotërojnë një certifikatë të mallrave të rrezikshme të lëshuar nga AACK, në pajtim me këtë Rregullore jo më vonë se 31 mars 2015.

37.2 Operatorët, vendi kryesor i biznesit i të cilëve është në Republikën e Kosovës dhe Certifikata e Operatorit Ajror (AOC) e të cilëve është lëshuar nga AACK-ë, duhet t'i nënshtrohen dispozitave të nenit 22.2 të kësaj Rregulloreje, që nga data 1 janar 2015.

37.3 Operatori i caktuar i postës do t'i nënshtrohet plotësisht dispozitave të neneve 20.5, 25.6 dhe 25.11 të kësaj Rregulloreje, jo më vonë se 31 mars 2015.

37.4 Ofruesit e trajnimit duhet t'i zbatojnë plotësisht dispozitat e kësaj rregulloreje, në mënyrë që të vazhdojnë kryerjen e aktiviteteve që lidhen me trajnimin mbi mallrat e rrezikshme dhe duhet të posedojnë certifikatën e ofruesit të shërbimeve të trajnimit të lëshuar në pajtim me këtë Rregullore, jo më vonë se 31 mars 2015.

**Neni 38**  
**Dispozitat përfundimtare**

Me këtë shfuqizohet Rregullorja nr. 6/2011 për transportin e mallrave të rrezikshme përmes ajrit dt. 25 qershor 2011.

**Neni 39**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi më datë 25 tetor 2014.

Prishtinë, 10 tetor 2014

**Dritan Gjonbalaj**  
Drejtor i Përgjithshëm